



Bruksel , 10.10.2012
SĚD (2012) 339

DOKUMENTI PUNUES I STAFIT TĚ KOMISIONIT

shoqeron dokumentin

**Komunikata e Komisionit pĚr Studimin e Fizibilitetit pĚr MarrĚveshjen e Stabilizim Asociimit mes
Bashkimit Evropian dhe KosovĚs***

{COM(2012) 602}

* Ky pĚrcaktim ěshtĚ pa paragjykim ndaj pozicioneve pĚr statusin, dhe ěshtĚ nĚ pĚrputhje me RezolutĚn 1244 dhe opinioni i GJND mbi shpalljen e pavarĚsisĚ sĚ KosovĚs.

DOKUMENTI PUNUES I STAFIT TË KOMISIONIT

shoqëron dokumentin

**Komunikata e Komisionit për Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit mes
Bashkimit Evropian dhe Kosovës**

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbajtja

Hyrja	4
1. KRITERET POLITIKE	5
1.1 Demokracia dhe sundimi i ligjit.....	5
1.1.1. Legjislatura	5
1.1.2. Ekzekutivi dhe Kryetari	6
1.1.3. Administrata Publike.....	7
1.1.4. Reformat e sektorit të sigurisë	8
1.1.5. Sistemi gjyqësor.....	8
1.1.6. Lufta kundër korrupsionit	10
1.1.7. Marrëdhëniet me bashkësinë ndërkombëtare.....	11
1.2 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave.....	12
1.2.1. Të drejtat civile, politike, ekonomike dhe sociale.....	12
1.2.2. Respektimi dhe mbrojtja e pakicave, të drejtave kulturore.....	13
2. KRITERET EKONOMIKE	15
2.1 Gjendja ekonomike dhe stabiliteti.....	15
2.1.1. Gjendja ekonomike	15
2.1.2. Politika fiskale	16
2.2 Liberalizimi i çmimit dhe i tregtisë.....	17
2.3 Privatizimi, zhvillimi i sektorit privat dhe reformat financiare.....	17
2.3.1. Privatizimi dhe zhvillimi i sektorit privat	17
2.3.2. Reformat e sektorit financiar.....	18
3. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA MSA.....	18
3.1 Dialogu politik	18
3.2 Bashkëpunimi regjional	19
3.3 Lëvizja e lirë e mallrave.....	19
<i>Politika tregtare</i>	<i>19</i>
3.4 Lëvizja e punëtorëve, themelimit, shërbimeve dhe kapitalit.....	22
3.4.1. Lëvizja e punëtorëve	22

3.4.2.	Themelimi	23
3.4.3	Furnizimi i shërbimeve	23
3.4.4.	Pagesat rrjedhëse dhe lëvizja e kapitalit.....	24
3.5	Përafrimi, implementimi dhe zbatimi i legjislacionit.....	24
3.5.1.	Konkurrenca.....	24
3.5.2.	Të drejtat e pronësisë intelektuale.....	25
3.5.3.	Prokurimi publik	26
3.5.4.	Standardizimi, akreditimi, vlerësimi i konformitetit, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut	27
3.5.5.	Mbrojtja e konsumatorit.....	28
3.6.	Drejhtësia dhe çështjet e brendshme	29
3.6.1	Fuqizimi i institucioneve dhe sundimi i ligjit	29
3.6.2	Azili migrimi, politika e vizave, kontrolli i kufijve/ kufijve administrativ	30
3.6.3	Luftimi i shpëlarjes së parave	31
3.6.4.	Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe aktiviteteve tjera kriminale, duke përfshirë terrorizmin	32
3.7.	Politikat e Bashkëpunimit	34
3.7.1.	Bashkëpunimi ekonomik, monetar, statistikor dhe mbrojtja e interesave financiare të BE-së.....	34
3.7.2.	Nxitja dhe mbrojtja e investimeve, bashkëpunimi industrial, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të)dhe turizmi.....	35
3.7.3.	Bujqësia.....	36
3.7.4.	Doganat,tatimet dhe kontrolli financiar	37
3.7.5.	Punësimi, politika sociale, politika e shëndetit publik, arsimimi dhe trajnimi, hulumtimi i teknologjisë dhe zhvillimi.....	39
3.7.6.	Shërbimet kulturore, audio vizuale, të telekomunikacionit, postare dhe shoqëria informative.....	42
3.7.7.	Transporti.....	43
3.7.8	Energjia ,përfshirë sigurinë bërthamore	44
3.7.9.	Mjedisi dhe ndryshimet klimatike.....	45
3.8	Bashkëpunimi Financiar	46

Hyrja

Parimet kryesore të Procesit të Stabilizim Asociimit (PSA) ishin të vendosura në Komunikatën e Komisionit në Maj të vitit 1999¹ dhe janë konfirmuar nga Këshilli në Qershor të vitit 1999. Përmes këtij procesi, Bashkimi Evropian (BE) shpreh vendosmërinë e tij për të marrë sfidën dhe përgjegjësinë për të kontribuar në stabilitetin e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Në kthim për përputhje me kushtet përkatëse, BE iu ofron vendeve marrëdhënie kontraktuale me porosi: Marrëveshje të Stabilizim Asociimit. Kushtet për vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale me vendet e Ballkanit Perëndimor janë vendosur në Konkluzionet e Këshillit të Prillit të vitit 1997. Elementet kryesore përfshijnë një përkushtim të besueshëm për të ndërmarrë reformat demokratike, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, minoriteteve dhe lirinë e shprehjes, dhe zgjedhje të lira dhe të rregullta. Këshilli gjithashtu pret zbatimin e reformave ekonomike, ri-pranimin nga Shtetet Anëtare dhe angazhimin për bashkëpunim rajonal.

Këshilli Evropian Feira (Qershor 2000) jep një sinjal të qartë për rajonin e Ballkanit Perëndimor duke krijuar statusin e kandidatëve potencial për anëtarësim. Ky mesazh është përforcuar edhe më tutje nga samiti i mbajtur në Zagreb (Nëntor 2000). Konkluzionet e Këshillit Evropian të Marsit të vitit 2003 deklarojnë se e ardhmja e Ballkanit Perëndimor është në kuadër të BE-së dhe vullnetit të fort politik si dhe përprjekjeve të vazhdueshme që janë të nevojshme për të siguruar atë. Agjenda e Selanikut për Ballkanin Perëndimor të Qershorit të vitit 2003 e bënë të qartë se vendet e Ballkanit Perëndimor dhe përkrahja për përgatitjen e tyre për integrimin e ardhshëm në strukturat evropiane dhe anëtarësimin përfundimtar në Bashkimin Evropian është prioritet i lartë për BE-në.

Deri më sot, studimet e fizibilitetit janë përgatitur për Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Kroacinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Serbinë dhe Malin e Zi. Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit janë nënshkruar me pas me të gjitha këto vende. Në Dhjetor 2011, Këshilli kujton gatishmërinë e BE-së për të ndihmuar zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës përmes një perspektive të qartë evropiane, në përputhje me perspektivën evropiane të rajonit. Këshilli nënvizon nevojën për të ndërmarrë hapa konkretë për këtë gjë. Në shkurt të vitit 2012, Këshilli merr parasysh synimin e Komisionit për të nisur studimin e fizibilitetit për një Marrëveshje të Stabilizim Asociimit në mes të Bashkimit Evropian dhe Kosovës, pa paragjykuar pozicionin e shteteve anëtare rreth statusit, apo të ndonjë vendimi të ardhshëm që do të merret nga Këshilli.

Qëllimi i këtij Dokumenti Punues të Stafit është që të sigurojë një analizë teknike të zhvillimeve politike, ekonomike dhe legjislativë në Kosovë. Dokumenti përshkruan progresin që Kosova ka arritur në tre vitet e fundit dhe konsideron se Kosova është e gatshme për të filluar negociimin për MSA-në. Ai gjithashtu përshkruan sfidat e pazgjidhura që Kosova përballlet për të përmbushur detyrimet e saja sipas një marrëveshje të tillë dhe jep një tregues të përkushtimeve të kërkuara në këtë kontekst. Kjo analizë është pa paragjykim ndaj statusit juridik të Kosovës dhe qëndrimeve të shteteve anëtare rreth statusit të Kosovës.

Dokumentit është i bazuar në kontributet e gjera nga autoritetet e Kosovës, Zyra e BE-së në Prishtinë, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat relevante ndërkombëtare dhe vendore jo-qeveritare. Komisioni gjithashtu është bazuar ndjeshëm në informatat e marra gjatë takimeve sektoriale dhe plenare të Dialogut të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit të organizuara mes Janarit dhe Korrikut 2012. Të gjeturat e këtij Dokumenti Punues të Stafit përbëjnë bazën e Komunikatës së Komisionit për një studim të fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës².

¹ COM (1999) 235 final

² COM (2012) 602 final

1. KRITERET POLITIKE

1.1 Demokracia dhe sundimi i ligjit

1.1.1. Legjislatura

Sistemi politik i Kosovës është i bazuar në parimet e demokracisë parlamentare. Kuvendi i Kosovës është institucioni kryesor legjislativ dhe zgjidhet direkt për një mandat katër vjeçar. Gjatë tre viteve të fundit, Kuvendi i Kosovës ka forcuar kapacitetet e tij dhe mbikëqyrjen e ekzekutivit. Përmirësimet mund gjithashtu të theksohen në lidhje me përgatitjen e legjislacionit dhe monitorimin e zbatimit të tij nga ana e komisioneve parlamentare përmes aktiviteteve në terren dhe dëgjimeve publike. Kosova ka ndërmarrë vetëm një reformë kryesore të kushtetutës saj, në të cilën Komiteti Kushtetuese i Reformave të Kuvendit ka luajtur një rol të rëndësishëm.

Në shtator 2011, Gjykata Kushtetuese sqaroi se deputetët kanë vetëm imunitet funksional. Prandaj, jashtë fushëveprimit të përgjegjësisë të tij/saj deputeti duhet të trajtohet si çdo qytetar tjetër. Kjo është mbrojtje e mjaftueshme për deputetët të ushtrojnë lirisht detyrat e tyre si anëtarë të Kuvendit.

Në përgjithësi, Kosova ka vendosur një kornizë institucionale për legjislacionin dhe kontrollin e ekzekutivit që është e bazuar mbi parimet demokratike.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të kenë angazhim të besueshëm për të ndërmarrë reforma demokratike dhe zgjedhje të lira dhe të rregullta. Kosova ka mbajtur zgjedhjet rregullisht në të dy nivelet qendrore dhe komunale. Sistemi është i bazuar në një konkurrencë të partive politike dhe votuesit mund të zgjedhin lirshëm mes tyre. Gjatë tre viteve të fundit, ka pasur koalicione qeveritare të ndryshme dhe parti të reja, duke përfshirë ato koalicione mjaft kritike të qeverisë, që mund të hyjë në Kuvend. Megjithatë, zgjedhjet e fundit parlamentare të vitit 2010/2011 u shënuan me mangësi serioze dhe vështirësi teknike. Është e rëndësishme që legjislacioni pasqyron më mirë praktikën më të mirë në BE dhe zbatimi është gjithashtu në përputhje me standardet ndërkombëtare. Për këtë qëllim, Kuvendi ka themeluar një komision ad hoc për reformën zgjedhore.

Gjithashtu është e rëndësishme që Kuvendi dhe Qeveria të vazhdojnë të përmirësojë koordinimin dhe planifikimin e tyre të përbashkët. Kapaciteti legjislativ i Kuvendit duhet të rritet më tej, sidomos Departamenti i Kuvendit për Çështje Ligjore dhe Procedurale. Procedura legjislative duhet të forcohet për të siguruar ekspertizë ndër-sektoriale dhe përputhshmëri me *acquis*. Organet përgjegjëse të Kuvendit kanë nevojë për të siguruar një mbikëqyrje të fortë të shpenzimeve buxhetore të parlamentit gjatë vitit financiar. Për më tepër, Kuvendi ka nevojë të forcoj funksionin e tij mbikëqyrës të ekzekutivit, nëpërmjet shqyrtimit të përmirësuar të legjislacionit dhe monitorimin e zbatimit të politikave dhe ligjeve.

Buxheti i Kuvendit, si edhe propozimet mbi ndryshimet në administrimin e tij, duhet të miratohen nga Qeveria. Këto procese duhet të bëhen edhe më të pavarura nga qeveria. Kjo mund të arrihet përmes miratimit të legjislacionit për statusin e nëpunësit civil të Kuvendit. Gjithashtu është e rëndësishme që qeveria të konsultohet me Kuvendin për ndryshimet në projekt-buxhetin e Kuvendit para se qeveria të dorëzon buxhetin për miratim në Kuvend.

Në lidhje me emërimet në institucionet e pavarura, siç është Institucioni i Avokatit të Popullit, por edhe agjencitë rregullatore dhe organet, Kuvendi përballlet me sfida në drejtim të vonesave dhe alokimit të mjeteve të mjaftueshme buxhetore. Vonesat dhe mungesa e buxhetit shkaktojnë vështirësi serioze për institucionet që të funksionojnë siç duhet dhe të zbatojnë mandatin e tyre.

Sipas MSA-së, Kosova do të angazhohet për forcimin e mëtejshëm të parimeve demokratike të qeverisjes së saj. Respekti për parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe të sundimit të ligjit në përgjithësi do të formojnë bazën e politikave të brendshme dhe të jashtme të palëve në një MSA-së.

1.1.2. Ekzekutivi dhe Kryetari

Qeveria mban mbledhje të rregullta dhe të shpeshta dhe propozon strategji legjislative ambicioze. Qeveria ka kapacitete të mira për të hartuar legjislacionin dhe ka potencial për të rritur përafrimin e legjislacionit me acquis në periudhë të shkurtër kohore. Koordinimi ndërministror i politikave është përmirësuar gjatë tre viteve të fundit.

Ministria e Integritimit Evropian drejton koordinimin e përgjithshëm të agjendës së BE-së përmes një Task Force për Integritim Evropian. Ministria ka demonstruar kapacitete të forta duke koordinuar me sukses vitin e tretë të takimeve sektoriale dhe plenare të Dialogut të Stabilizim Asociimit, si dhe nëpërmjet një inputi të plotë të institucioneve të Kosovës për përgatitjen e këtij studimi. Presidenti është gjithashtu aktiv në promovimin e agjendës së integritimit të BE-së në Kosovë. Këshilli Kombëtar për Integritim Evropian (i vendosur në kuadër të zyrës së Presidentit dhe i inauguruar në mars 2012) shërben si një organ i nivelit të lartë të koordinimit. Qëllimi i tij është që të ndërtojë një konsensus për agjendën evropiane përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe ndër-partiake.

Presidenti zgjidhet nga Kuvendi. Zgjedhja e tij/saj kërkon dy tretat e votave të të gjithë deputetëve për një mandat pesë vjeçar. Me vendimin e saj në korrik, Gjykata Kushtetuese konfirmoi gjatësinë e plotë të mandatit të Presidentit aktual. Presidentja në mënyrë aktive zbaton detyrat e saj kushtetuese dhe merr hapa për të kundërshtuar legjislacionin, për shembull, në qoftë se ajo nuk është në përputhje me praktikën dhe standardet evropiane (p.sh., legjislacioni lidhur me kriminalizimin e shpifjes dhe kërkesat për gazetarët që të zbulojnë burimet e tyre të informacionit). Kjo tregon se ka një ndarje të fuqisë sot në Kosovë.

Gjatë tre viteve të fundit, Kosova ka bërë përparim të rëndësishëm të decentralizimit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka ndërmarrë hapa për të siguruar një monitorim më efikas të strukturave të qeverisjes lokale.

Kosova ka vendosur institucionet e nevojshme të ekzekutivit dhe ka pasur edhe stabilitet të mjaftueshëm politik që ka mundësuar përparim në procesin e reformave të saj.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, Kosova ka nevojë që të përmirësojë qeverisjen e saj. Fokusi i Kosovës duhet të jetë në zbatimin e agjendës ambicioze të reformave të BE-së. Qeveria duhet të sigurojë që agjenda e saj legjislative më mirë të korrespondojë me kapacitetet e ministrive individuale dhe me buxhetin në dispozicion. Koordinimi mes qeverisë dhe Kuvendit gjithashtu ka nevojë për forcim të mëtejshëm.

Përpjekjet për zbatimin e decentralizimit duhet të vazhdojnë, duke përfshirë forcimin e administratës në nivel komunal. Sfidat përfshijnë kufizimet buxhetore, kapacitetet absorbuese, ekspertizën e dobët profesionale në nivel komunal, si dhe mungesën e vullnetit politik në nivel qendror e decentralizimit të kompetencave të saj në fushat e caktuara. Vendimmarrja gjithëpërfshirëse, si dhe proceset administrative dhe buxhetore janë vështirësuar nga mungesa e kapaciteteve të menaxhimit të të dhënave dhe kapaciteteve të planifikimit të bazuar në dëshmi. Autoritetet komunale kanë nevojë për një udhëheqje të porositur në nivel qendror si dhe zhvillimin e kapaciteteve të zgjeruara. Komunitetet e sapo themeluara me shumicë serbe gjithashtu përballen me këto sfida. Për më tepër, disa prej tyre kërkojnë ndihmë të mëtejshme nga niveli qendror për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre të madhësisë së vogël.

Decentralizimi mbetet një sfidë e veçantë në veri të Kosovës. Qeveria ka hapur një zyrë të re administrative në pjesën veriore të Mitrovicës për të ofruar shërbime për njerëzit. Është e qartë se zgjedhja

e këtyre sfidave politike kërkon një qasje konstruktive dhe proaktive të të gjitha palëve të përfshira. Në kuadrin e këtyre sfidave në veri, zbatimi i suksesshëm i decentralizimit në jug të lumit Ibër është thelbësor.

Sipas MSA-së, Kosova do të duhet të respektoj dhe zbatoj parimet demokratike të qeverisjes. Për më tepër, qeverisja e Kosovës do të duhet të sigurohet nëpërmjet një ekzekutiv të përshtatshëm dhe më efektiv në të gjitha nivelet e administratës.

1.1.3. Administrata Publike

Në pikëpamje të MSA-së, korniza ligjore, e shoqëruar nga politikat përkatëse dhe nga institucionet përkatëse për zbatimin e saj në të ardhmen duhet të vendoset. Pavarësia e organeve të administratës publike, si Institucioni i Avokatit të Popullit, duhet të respektohet.

Korniza ligjore ekzistues në fushën e administratës publike është e përshtatshme. Legjislacioni është frymëzuar nga qasjet më të fundit të administratës publike në Evropë. Ligjet mbi shërbimin civil dhe pagave në shërbimin civil sigurojnë kushtet ligjore për një shërbim civil të qëndrueshëm, të unifikuar dhe profesional. Korniza ligjore duhet të jetë e kompletuar, sidomos duke miratuar disa rregullore zbatuese të rëndësishme. Vonesat në zbatimin e legjislacionit të ri minojnë krijimin e një administrate publike profesionale dhe krijojnë kushtet për një vakum ligjor që është i dëmshme për procesin e reformës. Në afat të shkurtër, Kosova duhet të miratojë të gjitha aktet nënligjore për ligjet mbi shërbimin civil si dhe pagat për shërbimin civil.

Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës (IAP) është një nga organet kryesore të pavarura që lidhen me administratën publike. Kjo është një organ mbrojtës instrumental i të drejtave të njeriut dhe i cili përballet me sfida të mëdha, veçanërisht në aspektin e buxhetit dhe të lokaleve. Ka edhe ndërhyrje të rastit nga Ministria e Financave në buxhetin e tij, edhe pse Institucioni i Avokatit të Popullit është menduar të jetë financiarisht i pavarur. Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi duhet të rrisin ndjeshëm mbështetjen e tyre politike për Avokatin të Popullit dhe të vënë theksin në ndjekjen e vendimeve të tij. Në afat të shkurtër, Kosova ka nevojë të ndajë lokalet e përshtatshme për Avokatin e Popullit dhe të sigurojë pavarësinë e tij buxhetore duke obliguar qeverinë që të përfshijë projekt propozimin e Avokatit të Popullit për buxhet, pa ndonjë ndryshim, në projekt buxhetin global të dorëzuar në parlament.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, Kosova duhet të përqendrohet në veçanti në zbatimin e politikave dhe veprimeve në reformën e administratës publike, të pasqyruar në strategjinë, planin e veprimit dhe legjislacionin përkatës, duke përfshirë shpërndarjen e burimeve të mjaftueshme dhe të qëndrueshme. Deri më sot, ka pasur pak progres në zbatimin e strategjisë. Ka gjithashtu shqetësime lidhur me shpenzimet buxhetore të strategjisë dhe në lidhje me qëndrueshmërinë financiare të reformave të propozuar.

Trupi i dytë i rëndësishëm i pavarur në lidhje me administratën publike është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës (KPM). KPM luan një rol thelbësor për funksionimin e një administrate të përgjegjshme dhe të bazuar në ligj. Përputhja më të mirë me vendimet e KPM-së mbetet e një rëndësie të madhe për funksionimin e duhur të administratës dhe të një sistemi efektiv të kontrollit dhe balancave.

Ministria e Administratës Publike (MAP) është institucioni ligjor dhe institucion për hartimin e politikave në fushën e administratës publike dhe reformën e administratës publike. Megjithatë, Ministria ka personel të pamjaftueshëm për të pilotuar këto reforma të efektshme kyçe. Kjo pengon kapacitetin e saj për të kryer një rol koordinues, si dhe për të zbatuar strategjitë dhe legjislacionit. Përveç kësaj, MAP ka shumë pak kapacitete për të ndikuar në agjendën politike të qeverisë dhe në reformat që lidhen me administratën publike, dhe nuk merr mbështetje të mjaftueshme politike.

Sipas MSA-së, Kosova ka nevojë të rrisë edhe më tej përpjekjet e saj për të përmirësuar përgjegjshmërinë, profesionalizmin, efikasitetin dhe efektivitetin e administratës publike në të gjitha nivelet, që është

themelore për një zbatim të suksesshëm të reformave të nevojshme në të ardhmen. Qëllimi përfundimtar i këtyre përpjekjeve do të jetë funksionimi i duhur i institucioneve shtetërore për të mirën e popullatës.

1.1.4. Reformat e sektorit të sigurisë

Kosova ka vendosur kornizën kushtetuese dhe ligjore për rregullimin e sektorit të saj të sigurisë. Ka po ashtu edhe struktura institucionale për kontrollin demokratik të sektorit të sigurisë (p.sh. Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe Komisioni për Mbikëqyrjen Agjencisë Kosovare të Inteligjencës). Këshilli i Sigurisë së Kosovës, i kryesuar nga Kryeministri, është autoriteti kryesor për politikë-bërjen dhe këshillimin në lidhje me çështjet e sigurisë. Në situata të jashtëzakonshme, Këshilli mund të marrë një rol ekzekutiv. Akterët kryesorë në sektorin e sigurisë janë Policia e Kosovës, Agjencia Kosovare e Inteligjencës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës. Asnjë nga forcat e sigurisë lokale aktualisht nuk ka kapacitetet mbrojtës. Një rishikim i plotë strategjik i sektorit të sigurisë ka nisur dhe duhet të përfundojë në qershor të vitit 2013.

KFOR-i i NATO-s dhe misioni i BE-së për sundimin e ligjit EULEX do të vazhdojë të kontribuojë në sigurinë e Kosovës. Komisioni vë theks të veçantë në nevojën për Kosovën për të ruajtur një bashkëpunim të mirë me EULEX-in dhe në mënyrë aktive të mbështesë zbatimin e mandatit të tij.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA, shqyrtimi i sektorit të sigurisë nga ana e komisioneve parlamentare duhet të zgjerohet edhe më tej. Kuvendi i Kosovës duhet të zhvillojë më tej aftësinë e tij për të kryer një mbikëqyrje efektive të këtij sektori. Për më tepër, partitë kryesore politike vazhdojnë të mbështesin në marrëveshjet e tyre sigurinë joformale, që është një çështje e shqetësimit serioz.

Sipas MSA-së, Kosova do të ketë nevojë të forcoj edhe më tej kontrollin demokratik të sektorit të sigurisë.

1.1.5. Sistemi gjyqësor

Gjatë tre viteve të fundit, ka pasur reforma të rëndësishme të gjyqësorit. Një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore (ligjet për gjykatat, për Këshillin Prokurorial të Kosovës, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe për Prokurorinë) u miratua në vitin 2010. Zbatimi i plotë i këtyre ligjeve, që përbën një reformë të madhe gjyqësore dhe prokuroriale, do të çojë në futjen e një sistemi gjyqësor të ri më 1 janar 2013 (me shtatë gjykatat themelore dhe një Gjykatë të Apelit). Parimet e pavarësisë, paanshmërisë, llogaridhënies dhe efikasitetit janë në zemër të kësaj reforme. Pavarësia e gjyqësorit është e garantuar në legjislationin e Kosovës, që kërkon nga gjyqësori që të veproj në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.

Gjykata Supreme është autoriteti më i lartë gjyqësor në Kosovë. Gjykata Kushtetuese, si mbrojtës i kushtetutës së Kosovës, është e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj. Gjykata ka nxjerrë një numër të vendimeve të rëndësishme me ndikime të forta politike, të cilat kanë qenë të respektuar nga të gjitha autoritetet dhe liderët politik.

Përveç strukturës së përgjithshme të gjykatës, Kosova ka themeluar institucionet kyçe të gjyqësorit, sidomos Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës (TMK). Kompensimi në gjyqësor është përmirësuar që nga viti 2011, me vendosjen e gjyqësorit në pozitë të barabartë me shtylla ekzekutive dhe legjislative, që i mundëson sektorit të tërheq profesionistë të kualifikuar, dhe që të ketë potencial të ndihmojnë parandalimin e ndikimit të jashtëm në stafin gjyqësor. Kosova ka arritur kapacitete të mjaftueshme në këtë fushë. Elementet kryesore të kornizës legjislative, si dhe institucionet kyçe, me kapacitete të përmirësuara dhe një kuptim të mirë të sfidave të mbetura, janë themeluar. Ndërsa zbatimi i reformës gjyqësore, në Kosovë ka nevojë për t'u siguruar se kompetencat e Prokurorisë Speciale nuk janë ndryshuar në dritën e strukturës së re të gjykatës. Prezantimi i një ode të veçantë mbi korrupsionin dhe krimin e organizuar duhet të pasqyroj kompetencën aktuale dhe qëllimin e Prokurorisë Speciale.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, Kosova duhet të përqendrohet në veçanti në përmirësimin e pavarësisë, efektivitetit, përgjegjshmërisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit. Kosova ka nevojë për të siguruar zbatimin e suksesshëm të reformës gjyqësore. Kosova gjithashtu duhet të sigurojë sigurinë e duhur dhe masat mbrojtëse për gjyqtarë, prokurorë, dëshmitarë dhe ankues, si dhe për personelin e gjykatave, dhe ka nevojë siguroj mbrojtje efektive kundër kërcënimeve apo frikësimeve. Bashkëpunimi ndërkombëtar gjyqësor i Kosovës duhet të jetë më proaktiv që çon në hetime. KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të rrisin punësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga pakicat, siç është përcaktuar në kornizën ligjore.

Ka sfida të mëtejshme për gjyqësorin ku progresi duhet të bëhet nga Kosova. Procedura e zgjedhjes së votimit të anëtarëve të KGJK-së duhet të bëhet në përputhje me standardet përkatëse evropiane (dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias), për të siguruar që shumica e anëtarëve të votimit janë zgjedhur nga kolegët e tyre. Për të siguruar zbatimin e suksesshëm të sistemit të ri të gjykatave nga 1 janari 2013, burimet e saj financiare dhe njerëzore duhet të rriten. Ndryshimet e mëtejshme në paketën e katër ligjeve dhe në ligjin për Prokurorinë Speciale, të cilat janë aktualisht në përgatitje e sipër, mund të prishin sistemin e drejtësisë dhe të shkaktojnë vështirësi në kalim në strukturën e re të gjykatës.

Në vitin 2009, të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët iu nënshtruan procesit të verifikimit dhe riemërimit të kryesuar nga Komisioni Ndërkombëtar Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP). Numri i gjyqtarëve është aktualisht i pamjaftueshëm, ka mungesë të veçantë të gjyqtarëve civil në gjykatat e shkallës së dytë. Përpjekje janë të nevojshme për të finalizuar procesin e përzgjedhjes për gjyqtarët dhe prokurorët, duke plotësuar pozicionet e mbetura (aktualisht 29 prokurorë dhe 51 gjyqtarë), sidomos për pakicat, për të cilat legjislacioni i Kosovës rezervon një numër të caktuar të pozitave. Këshillat Gjyqësor dhe Prokurorial kanë realizuar një fushatë në terren të këtyre pakicave, sidomos serbëve, por përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme në këtë drejtim. Gjyqtarët dhe prokurorët lokal serb të Kosovës refuzuan t'i nënshtrohen procesit të verifikimit (të udhëhequr nga KPGJP) dhe ende hezitojnë të aplikojnë për pozita të lira që shpallen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Akuzat e sjelljes së korruptuar në gjyqësor vazhdojnë. Pavarësia e kufizuar dhe paanshmërinë e gjyqësorit në praktikë është një pengesë serioze për forcimin e sundimit të ligjit. Këshillat Gjyqësor dhe Prokurorial duhet të sigurojnë që çdo shkelje disiplinore apo penale e kryer është adresuar fuqishëm për të përmirësuar reputacionin e gjyqësorit. Këshillat dhe institucionet tjera të Kosovës duhet adresuar ngurrimin e prokurorëve dhe gjykatësve të Kosovës për të ndjekur penalisht dhe gjykuar rastet politikisht të ndjeshme apo të profilit të lartë ndaj të pandehurve me ndikim.

Akuzat e kërcënimeve dhe frikësimeve janë të shpeshta dhe vazhdojnë të ekzistojnë në gjyqësi. Ligji mbi gjykatat siguron bazën ligjore për masat mbrojtëse, por Kosova duhet të bëjë më shumë për të rritur sigurinë për gjyqësorin. Qasja në, dhe në kontrollin e lokaleve të gjykatës mbetet e dobët, publiku ka qasje të papenguar në zyrat e gjyqtarëve dhe disa gjykime janë mbajtur në zyrat e gjyqtarëve në vend të gjykatave. Kjo nuk është vetëm një çështje nga pikëpamja e sundimit të ligjit, por edhe ka potencial për të krijuar rreziqe të sigurisë për gjyqtarët dhe stafin administrativ të gjykatës. Masat e duhura të sigurisë duhet të jetë kusht për prokurorët, dëshmitarët dhe ankuesit.

Zbatimi i vendimeve, në të dyja rastet civile dhe penale, është i dobët. Kjo është një pengesë e madhe në drejtim të krijimit të besimit në gjyqësor. Kosova duhet të përqendrohet më shumë në krijimin e mjeteve për të zbatuar dhe fuqizuar legjislacionin dhe vendimet gjyqësore. Në këtë drejtim, sistemi aktual i përmbartës gjyqësor ka nevojë të reformohet që të jenë më efikas kur bëhet fjalë për zbatimin e rasteve të gjykimeve civile.

Në drejtim të rritjes së efikasitetit, Këshilli Gjyqësor miratoi një strategji për zvogëlimin e rasteve të pazgjidhura që të merren me mbi 160.000 raste të grumbulluara nga 31 dhjetor 2008. Deri më sot, më shumë se 55% e numrit të këtyre lëndëve janë gjykuar. Megjithatë, prirja e përgjithshme tregon një rritje në numrin e përgjithshëm të rasteve gjyqësore të pazgjidhura që nga numri i rasteve të paraqitura (pas

datës 31 dhjetor 2008) vazhdon të jetë më i lartë se numri i rasteve të zgjidhura. Kjo mund të jetë pjesërisht për shkak të sistemit të regjistrimit, i cili duhet të jetë i efektshëm.

Qasja në drejtësi është penguar në veri të Kosovës. Gjykata e Qarkut e bazuar në pjesën veriore të Mitrovicës ka staf vetëm prej 6 gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe 2 prokurorë ndërkombëtarë të EULEX-it. Komuniteti serb në veri nuk pranon gjyqtarë vendorë në gjykatë. Gjykatat paralele komunale serbe ekzistojnë në veri, por ato kryesisht merren me rastet civile. Për vepra penale nuk ka mekanizma të zbatimit të ligjit në veri përveç të EULEX-it.

Sipas një MSA, respektimi i parimit të sundimit të ligjit është reflektuar në bashkëpunim për konsolidimin e sundimit të ligjit, forcimin e institucioneve në përgjithësi si dhe të zbatimit të ligjit dhe administrimin e drejtësisë në veçanti. Bashkëpunimi në bazë të MSA-së kërkon forcimin e mëtejshëm të pavarësisë së gjyqësorit dhe përmirësimin efiçencës së tij.

1.1.6. Lufta kundër korrupsionit

Në pikëpamje të MSA-së, Kosova ka nevojë të ketë një kornizë ligjore për luftimin e korrupsionit, të shoqëruar nga politika dhe institucionet për zbatimin e saj.

Gjatë tre viteve të fundit, Kosova ka ndërmarrë një numër hapash të rëndësishëm për të luftë kundër korrupsionit duke zbatuar elementet e nevojshme të kornizës ligjore: Ligjet për deklarimin e pasurive, parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, informatorët, prokurimi publik dhe financimi i partive politike. Korniza aktuale ligjore ka dispozita të forta të mjaftueshme për të sjellë rezultate të prekshme në këtë fushë.

Kosova ka themeluar Agjencinë e pavarur Anti-Korrupsion në vitin 2006. Agjencia është institucioni kryesor për monitorimin e zbatimit të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave dhe ligjit mbi deklarimin e pasurisë së zyrtarëve publikë, si dhe të strategjisë anti-korrupsion dhe planit të veprimit. Ajo gjithashtu merret me përpunimin e ankesave individuale për rastet e mundshme të korrupsionit dhe është e obliguar të njoftojë autoritetet tjera të tilla si policinë dhe prokurorinë, nëse ajo gjen arsye për hetim të mëtejshëm. Këshilli Nacional i Anti-Korrupsionit është themeluar nga Presidentja e Kosovës në shkurt të vitit 2012. Këshilli synon të përmirësojë koordinimin dhe të rrit vetëdijen në mesin e të gjitha organeve dhe institucioneve të përfshira në luftën kundër korrupsionit.

Në aspektin e kapaciteteve administrative, gjatë tre viteve të fundit, prokuroria dhe policia janë riorganizuar me qëllim që të përmirësohet lufta kundër korrupsionit. Në vitin 2010, Prokuroria Speciale ka krijuar një task forcë anti-korrupsion të përbërë nga prokurorë (nga Kosova dhe EULEX-i) dhe hetuesit e policisë. Qëllimi i kësaj task force është hetimi kriminel ekonomik dhe financiar. Policia gjithashtu ka themeluar një Drejtori kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit. Departamentet e inspektimit janë themeluar në shumë autoritete dhe institucione, me qëllim që të adresohet dhe monitorohet situata në lidhje me korrupsionin dhe/apo sjelljen kriminale brenda vetë organizatës. Në përgjithësi, Kosova ka elemente të mjaftueshme të vendosura në kornizën ligjore, sikurse edhe institucione përkatëse. Në afat të shkurtër, Kosova ka nevojë të demonstrojë një angazhim të qartë për të dhënë rezultate në luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë kështu fillimin e hulumtimeve, në bashkëpunim me EULEX-in. Kosova duhet të miratojë një strategji të re anti-korrupsion.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, Kosova ka nevojë të ofroj hetimet dhe ndjekjen e rasteve të korrupsionit dhe të përmirësojë besueshmërinë e statistikave në luftën kundër korrupsionit. Është e qartë se ka sfida të mëtejshme që Kosova ka nevojë t'i adresoj. Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave ka nevojë për obligime përkatëse të raportimit pasi që aktualisht rastet e konfliktit të interesit vazhdojnë të jenë kryesisht jo të raportuara. Sanksionet e parashikuara në ligjet për deklarimin e pasurisë dhe në konfliktin e interesave (gjoba deri në një maksimum prej 2,500 € apo një ndalim për të ushtruar një

funkcion publik për periudhë maksimale prej një viti), janë mjaft simbolike dhe ligjet duhet të sigurojnë sanksione bindëse si dhe proporcionale.

Financimi i partive politike nuk është mjaft transparent. Ligji për financimin e partive politike përmban disa dobësi që duhet të adresohen. Ai duhet të ndaloj ose rreptësisht të rregulloj donacione nga subjektet juridike që sigurojnë mallra apo shërbime për administratën publike. Ai gjithashtu duhet të detyroj partitë politike që të kenë një llogari të vetme bankare dhe të përcaktoj afatet për publikimin e raporteve të tyre financiare.

Kosova gjithashtu duhet të miratojë strategjinë e re dhe planin e ri të veprimit për luftën kundër korrupsionit. Vlerësimi i strategjisë anti-korrupsion 2009-2011 sugjeron zbatimin e kufizuar të saj për shkak të mungesës së bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional, si dhe mungesën e mbështetjes dhe angazhimit nga udhëheqja e lartë në të gjitha institucionet publike.

Për të siguruar që strategjia e re është zbatuar me sukses, dhe se progresi do të jetë i dukshëm në luftën kundër korrupsionit, Kosova ka nevojë të thjeshtoj vendosjen institucionale në luftë kundër korrupsionit dhe të shmang mbingarkesën e përgjegjësive. Hetimet dhe ndjekjet penale të suksesshme janë të rëndësishme. Për këtë arsye ka nevojë që të përmirësohet bashkëpunimi në mes të autoriteteve gjyqësore për zbatim dhe për t'i bërë ato më efikase dhe efektive, dhe për të përmirësuar besueshmërinë dhe krahasueshmërinë e statistikave në këtë fushë. Mbështetja e nivelit të lartë politik duhet të sigurohet për përkrahjen e punës në luftë kundër korrupsionit, vullnetit politik të shprehur në mbledhjet e Këshillit Anit Korrupsion duhet të vihet në praktikë.

Sipas MSA, bashkëpunimi do të synojnë forcimin e mëtejshëm të pavarësisë së gjyqësorit dhe përmirësimin e efikasitetit të tij, si dhe përmirësimin e funksionimit të policisë dhe organeve të tjera të zbatimit të ligjit në luftën kundër korrupsionit.

1.1.7. Marrëdhëniet me bashkësinë ndërkombëtare

Kosova është njohur nga 92 vende. Kosova nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara (OKB), e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ose e Këshillit të Evropës (KE), dhe kështu nuk është në gjendje që plotësisht të përfitojnë nga mekanizmat e vlerësimit të konventave përkatëse. Të tri organizata janë të pranishme në Kosovë. Kosova nuk është anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë. Është anëtare e Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) me të cilët ajo ka një marrëveshje mbështetëse. Kosova ka bashkëpunim të mirë me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.

BE-ja ka një prani të fortë në Kosovë. Në fillim të vitit 2012, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian dhe zyra e Përfaqësuesit Special u bashkuan në një Zyrë të BE-së, dhe kreu me funksion të dyfishtë i EUSR/Shefi i Zyrës është emëruar. Gjë që ka strukturuar dhe zgjeruar dukshmërinë e BE-së në Kosovë.

BE ka zgjatur mandatin, duke përfshirë fuqitë ekzekutive të caktuara të misionit të sundimit të saj të ligjit, EULEX, i cili do të skadojë në qershor të vitit 2014. Mandati i EULEX-it u miratua nga Kuvendi në shtator. Autoritetet e Kosovës janë angazhuar për të bashkëpunuar plotësisht me Task Forcën Speciale Hulamtuese të EULEX-it, e cila heton akuzat e ngritura nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në rezolutën e saj të janarit 2011.

Bashkëpunimi i përforcuar midis EULEX-it dhe institucioneve lokale, të tilla si Prokuroria Speciale, ka çuar në rritjen e numrit të arrestimeve dhe garancitë e kërkimit. Kosova ka nevojë të mbajë bashkëpunim që çon në rritjen e numrit të të arrestuarve dhe urdhër arrestete. Kosova duhet të mirëmbaj bashkëpunimin e mirë me EULEX-in, duhet të vazhdojë të mbështesë në mënyrë aktive zbatimin e mandatit të tij, duke përfshirë edhe atë të Task Forcës Speciale Hulamtuese.

KFOR-i gjithashtu ka vazhduar duke ndihmuar ofrimin e sigurisë, sidomos në veri të Kosovës. Prania e tij e përgjithshme është rreth 5,600.

Grupi Drejtues Ndërkombëtar (ISG), ka vendosur që Kosova ka zbatuar ndjeshëm kushtet e Propozimit Gjithëpërfshirës dhe që Kosova të miratoj kornizën e nevojshme kushtetuese dhe ligjore, shpalli fundin e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, dhe fundin e mandatit të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar më 10 shtator.

1.2 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave

1.2.1. Të drejtat civile, politike, ekonomike dhe sociale

Kosova ka një bazë solide ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave themelore. Këto garanci janë drejtpërdrejt të mishëruara në kushtetutën e Kosovës. Kosova është e detyruar të siguroj që legjislacioni i vet, politikat dhe praktikat t'i përmbushin kërkesat ndërkombëtare. Kushtetuta liston marrëveshjet kryesore ndërkombëtare dhe instrumentet drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë, duke përfshirë Deklaratën Universale të së Drejtave të Njeriut, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, dhe Protokollin e saj. Në rast të konfliktit, kjo e fundit të marrë përparësi mbi ligjet e brendshme. Ky është një mekanizëm i rëndësishëm, pasi Kosova nuk është anëtare e OKB-së ose e Këshillit të Evropës, për shkak të konsideratave të statusit. Për më tepër, Kushtetuta parashikon individët me të drejtën të ngrit shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, në Gjykatën Kushtetuese. Avokati i Popullit gjithashtu mund të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese.

Kuvendi i Kosovës ka një Komitet të specializuar për të Drejtat e Njeriut, Barazinë Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione. Mandati i tij është për të shqyrtuar projektligjet dhe për të siguruar përputhshmërinë me legjislacionin ndërkombëtar dhe evropian për të drejtat e njeriut. Gjatë tre viteve të fundit, Kosova ka krijuar disa struktura në nivel qendror dhe komunal për të ndihmuar mbrojtjen, promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave themelore. Komuniteti ndërkombëtar ka qenë i përfshirë intensivisht në ndërtimin e kapaciteteve të Kosovës në këtë fushë gjatë tre viteve të fundit.

Në përgjithësi, institucionet e Kosovës kanë marrë iniciativa të mira për të filluar zbatimin e të drejtave të njeriut dhe të atyre themelore, si dhe për rritjen e vetëdijes së përgjithshme në lidhje me këto të drejta.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, Kosova duhet të përqendrohet në veçanti në riorganizimin dhe thjeshtimi e numrit të madh të organeve që merren me mbrojtjen e këtyre të drejtave për të siguruar monitorim efektiv dhe zbatimin e kornizës ligjore në këtë fushë. Për më tepër, fokusi duhet të jetë në lirinë e shprehjes. Liria e shprehjes dhe liria e mediejeve janë të garantuara me Kushtetutë. Më shumë duhet të bëhet për të siguruar se ato janë të respektuar në praktikë. Kosova ka nevojë për të hetuar dhe ndjekur penalisht çdo sulm fizik kundër gazetarëve dhe të përfundoj procedurën parlamentare për të ndryshuar Kodin Penal për përgjegjësinë penale të mediejeve dhe mbrojtjen e burimeve të gazetarëve. Lidhur me të drejtat e pronësisë, ka dobësi në sistemet ekzistuese dhe në kornizën ligjore, si dhe në zbatimin e saj. Kosova duhet të bëjë përparim në zbatimin dhe respektimin e të drejtave të pronësisë, për shembull përmes zvogëlimit të numrit të lëndëve dhe në përmirësimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe administrative.

Pas raportit të tetorit 2011 të Komitetit të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor ose Degradues apo Ndëshkimit (KPT), kushtet në disa institucione të paraburgimit janë përmirësuar. Në këtë kontekst, Kosova ka nevojë të vazhdojë monitorimin e situatës në lidhje me *torturimin* dhe *keqtrajtimin*, duke siguruar përmirësime në të gjitha objektet. Gjatë tre viteve të fundit, Kosova gjithashtu gradualisht ka përmirësuar standardet në *sistemin e burgjeve*. Ministria e Drejtësisë duhet të vazhdojë përpjekjet e saj për të rritur profesionalizmin e stafit korrektues.

Në të njëjtën kohë, Kosova ka nevojë të vazhdojë adresimin e çështjeve të tjera. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të trajtuar çështjet e *mosndëshkimit dhe qasjes në drejtësi* duke bërë gjyqësori të punojnë në mënyrë më efektive. Procedurat ngadalë duhet të eliminohen në mënyrë efektive dhe gjykimet të zbatohen. Kjo përfshin nevojën për të siguruar qasje në drejtësi në praktikë, sidomos për grupet më të rrezikuara në shoqëri, duke përfshirë edhe viktimat e trafikimit. Fati i personave të zhdukur gjatë konflikteve në vitet 1990 (1770 raste në gusht 2012) mbetet një shqetësim humanitar. Për të identifikuar fatin e *personave të pagjetur* kërkohen burime të mëtejshme dhe bashkëpunimin aktiv rajonal. *Liria e tubimit dhe e organizimit*, si dhe *liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë* janë të garantuara përmes legjislacionit adekuat dhe janë respektuar në përgjithësi, edhe pse mund të zbatohen në mënyrë më aktive.

Korniza ligjore e Kosovës siguron *të drejtat e grave*. Barazia gjinore është gjithashtu e garantuar edhe në sistemin ligjor, por zbatimi është i ngadalshëm. Zbatimi i ligjit për mbrojtje kundër dhunës në familje duhet të përmirësohet. Konventa mbi të *Drejtat e Fëmijës* është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë. Sistemi i drejtësisë për të mitur vepron në bazë të Kodit të Drejtësisë për të Miturit, që është gjerësisht në përputhje me standardet e BE-së. Legjislacioni për *anti-diskriminimin* është i përshtatshëm, edhe pse zbatimi i tij praktik mbetet një sfidë. Është i nevojshëm vullneti më i madh politik për të promovuar tolerancën. *Personat me aftësi të kufizuara* janë të ballafaquar me qasje të pakët në punësim, mallra dhe shërbime, transport dhe arsim. Sfidë kryesore për personat me aftësi të kufizuara është çështja socio-ekonomike. Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet këtij grupi personash, kur bëhet hartimi i politikave të punësimit. Zbatimi i *të drejtave të sindikatës së punës dhe të tregtisë* duhet të përmirësohet më tej, duke përfshirë rritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së inspektorëve të punës.

Sipas MSA-së, Kosova do të duhet të respektoj dhe zbatoj parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut, sikurse përcaktohet në dokumentet kryesore ndërkombëtare siç është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Respektimi i parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe të sundimit të ligjit në përgjithësi do të formoj bazën e politikave të brendshme dhe të jashtme të palëve në MSA-së. Kosova do të ketë nevojë që të siguroj të drejtat dhe liritë themelore që të jen të garantuara dhe zbatimi i tyre gradualisht të përmirësohet.

1.2.2. Respektimi dhe mbrojtja e pakicave, të drejtave kulturore

Në pikëpamje të MSA-së, duhet të jetë një kornizë ligjore që garanton mbrojtjen e pakicave dhe të të drejtave kulturore. Zbatimi i këtyre të drejtave duhet të mbështetet nga një strukturë adekuate institucionale.

Kosova ka një bazë solide ligjore për mbrojtjen e pakicave dhe të trashëgimisë kulturore. Këto garanci janë garantuara drejtpërdrejtë edhe në kushtetutën e Kosovës si dhe janë të rregulluara me ligjin për mbrojtjen dhe të drejtat e pakicave. Sikurse Korniza e Këshillit të Evropës, Konventa për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë dhe ka përparësi mbi legjislacionin e Kosovës, Kosova ka detyrime të qarta për të siguruar që legjislacioni i vet, politikat apo praktikat që përmbushin kërkesat ndërkombëtare. Kjo është e rëndësishme duke marr parasysh se Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës.

Pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur, Kushtetuta e Kosovës dhe legjislacioni vazhdon të ketë garancionin e përfaqësimit, të drejtave kulturore, të drejtave gjuhësore të pakicave të saj, si dhe të drejtave të Kishës Ortodokse Serbe. Aktualisht, përfaqësuesit e pakicave kanë 25 vende të garantuara në Kuvend si pasojë e sistemit të ulëseve të garantuara dhe të rezervuara (13 për komunitetin serb dhe 12 për pjesëtarët e pakicave të tjera). Dy nga pesë deputetët të Kryesuesit të Kuvendit janë nga pakicat jo-shqiptare. Personat që u përkasin pakicave janë të përfaqësuara mirë edhe në qeveri.

Në aspektin e të drejtave gjuhësore, Komisioni i reformuar Gjuhëve ka potencialin për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave gjuhësore. Buxheti, stafi dhe zyrat duhet t'i ndahen Zyrës së Komisionerit Gjuhësor. Ligji për Transmetuesin Publik parashikon themelin e një kanali në gjuhën serbe. Ai duhet të

fillojë transmetimin. Në fjalimin e saj vjetor, Presidentja iu drejtua Kuvendit në gjuhën serbe si dhe shqipe: një shenjë pozitive, që duhet të ndiqet nga liderët e tjerë politikë dhe institucionet e Kosovës.

Në lidhje me Komunitetin Ashkali, Rom dhe Egjiptas, aplikimi i Kosovës për anëtarësim në Dekadës Rome është një nismë pozitive. Me mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare, Kosova është duke mbyllur kampet e kontaminuara me plumb.

Me mbështetjen e fortë të komunitetit ndërkombëtar, Kosova ka vazhduar duke ofruar mundësinë e kthimit. Në përgjithësi, mbi 23.000 persona që u përkasin pakicave janë kthyer në Kosovë që nga konflikti i viteve 1990.

Sa i përket, të drejtave kulturore duke përfshirë trashëgiminë kulturore, Kosova është duke ndërmarrë hapa për të zbatuar konventat e Këshillit të Evropës dhe UNESCO për të drejtat kulturore. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore është përmirësuar disi pas miratimit të legjislacionit përkatës, por zbatimi ka ngecur, sidomos në nivelin komunal. Autoritetet e Kosovës kanë marrë përsipër me sukses nga KFOR-i sigurinë e shumicës së vendeve kulturore dhe fetare të Kishës Ortodokse Serbe; vetëm dy vende – Patriarkana e Pejës dhe i Manastirit Deçanit – janë të mbrojtura ende nga KFOR-i.

Në afat të shkurtër, Kosova ka nevojë të siguroj ekzistencën e një organi të përshtatshëm që mundëson konsultimin e drejtpërdrejtë në promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore me komunitetet fetare, sidomos të Kishës Ortodokse Serbe.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, Kosova duhet të përqendrohet në promovimin e Kosovës multietnike. Ajo ka nevojë që të krijoj kushte për serbët që ndjehen pjesë e të ardhmes së Kosovës dhe kushtet për kthimin për personat që dëshirojnë të bëjnë kështu. Buxheti, stafi dhe lokalet duhet të ndahen për Zyrën e Komisionerit të Gjuhësor. Ajo është po aq e rëndësishme për të zbatuar legjislacionin që lidhet me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe të Kishës Ortodokse Serbe sidomos ligjet për qendrën historike të Prizrenit dhe për fshatin Hoçë e Madhe. Transmetimin nga transmetuesi publik duhet të sigurohet në gjuhën serbe. Sulmet fizike të motivuara në baza etnike apo fetare duhet të hetohen dhe kryerësit të sillen para drejtësisë. Kosova ka nevojë edhe për progres në zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit për komunitetin të ashkalive, romëve dhe egjiptianëve, përfshirë alokimin e fondeve të nevojshme. Kosova ka nevojë për të rritur pjesën e përgjithshëm të personave që u përkasin minoriteteve në administratën publike.

Është e qartë se ka çështje të tjera në këtë fushë që Kosova ka nevojë që t'i adresoj. Sfidat lidhen edhe me zbatimin e legjislacionit dhe të kuadrit politik. Kosova ka nevojë për të përmirësuar më tej zbatimin e legjislacionit për përdorimin e gjuhëve zyrtare në nivel institucional dhe shoqëror në tërë Kosovën. Të "Dyzet Veprimet" për të integruar romët, ashkalitë dhe egjiptianët duhet të zbatohen si në nivel qendror ashtu edhe në atë komunal. Këto pakica janë të prekshme dhe ato vuajnë edhe diskriminimin direkt dhe indirekt. Gjithashtu ato kanë qasje të kufizuar në sistemin arsimor të Kosovës. Qasja në arsim, lufta kundër braktisjes së shkollës, si dhe rezultatet cilësore të arsimit duhet të plotësojnë plan programin e fundit të romëve. Çështje të ngjashme vazhdojnë në lidhje me pakicën turke, boshnjake dhe gorane. Mësimdhënia dhe nxënia e gjuhëve të pakicave të tjera nuk është promovuar sa duhet.

Me regjimin aktual, operatorët ekonomikë janë të informuar mirë në lidhje me rregullat e prokurimit. Njoftimi për tender përfshin informata të mjaftueshme për atë që kanë për qëllim të furnizohen, si dhe për vlerësimin dhe kriteret e kualifikimit. Procedura e kufizuar është përcaktuar si një procedurë normale që mund të zgjidhet si një alternativë për procedurën e hapur. Kontratat me vlerë të madhe duhet të nënshkruhen nga zyrtarët ekzekutiv dhe ministrat. E-prokurimit është duke u zbatuar. Autoritetet kontraktuese janë drejtpërdrejtë përgjegjëse në qoftë se nuk publikojnë njoftimin për tender për një procedurë të negociuar dhe nëse nuk i ndjekin kërkesat e përgjithshme për një minimum prej tre tenderuesve.

Sistemi i prokurimit publik në Kosovë përbëhet nga 161 Autoriteteve Kontraktuese (530 Zyrtarë të prokurimit janë duke punuar në organet e prokurimit publik). Strukturimi institucional përfshin Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik që është përgjegjës për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik, duke përfshirë monitorimin e përdorimit të procedurës së negociuar, kriteret kualifikuese për përzgjedhje dhe vlefshmërinë e nënshkrimit të kontratës. Trupi Shqyrtues i Prokurimit është një organ i pavarur për shqyrtim administrativ që ka të bëjnë me ankesat. Agjencia Qendrore e Prokurimit është rifokusuar në blerjen qendrore. Këto tre institucione tani kanë rregulla të reja të procedurave dhe udhëzimeve të reja operative.

Bordi dhe Komisioni mbeten institucione të pavarura. Ata emërohen nga Qeveria dhe emërohen nga Kuvendi. Ata i raportojnë drejtpërdrejt Kuvendit. Agjencia është vendosur tani në kuadër të Ministrisë së Financave dhe administrohet nga drejtori i cili ende duhet të emërohet. Qeveria nuk ka miratuar ende listat e zakonshme të përdorimit të artikujve për blerjen e detyrueshme qendrore, që dobëson aftësinë e Agjencisë për të kryer funksionet e veta.

Shqyrtimi i ankesave bëhet ekskluzivisht nga Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe ligji nuk parashikon ankesat që do të paraqiten me autoritetin kontraktues në një fazë të parë. Një panel i përbërë nga një ose tre anëtarë të bordit shqyrton raste. Procedura Shqyrtimi përfshin edhe dëgjime publike dhe vendimet janë në dispozicion në ueb faqe. Taksa e ankesave është 500 € ndërsa gjatë e shqiptuara janë sistematikisht jo më pak se 5.000 €

Kosova ka edhe legjislacionin për partneritetet publiko-private, që përcakton një kornizë të qëndrueshme ligjore për koncesionet e punës dhe që është kryesisht në përputhje me legjislacionin e BE.

Nuk ka asnjë diskriminim midis kompanive vendase dhe të huaja në Kosovë, korniza ligjore është në përputhje me BE-në dhe praktikat ndërkombëtare, dhe administrata në krye të prokurimit është duke funksionuar.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, Kosova ka nevojë për të vënë theks më shumë në sigurimin e pajtueshmërisë, në veçanti sa i përket Agjencisë së Prokurimit. Integriteti dhe transparenca e proceseve duhet të rritet. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të siguruar se rastet e korrupsionit dhe mashtrimit janë trajtuar dhe ndjekur penalisht me sukses. Korrupsioni në fushën e prokurimit duhet të adresohet. Profesionalizmi i zyrtarëve të prokurimit duhet të përmirësohet më tej me theks më shumë në cilësi të lartë trajnimeve. Qarkullimi i zyrtarëve të prokurimit është ende i rëndësishëm dhe ka nevojë të trajtohet.

Sipas MSA-së, Kosova do të duhet të siguroj që kompanive të BE-së iu garantohet qasja në procedurat e dhënies së kontratës në bazë të trajtimit jo më pak të favorshëm se për kompanitë vendase, në përputhje me një periudhë kalimtare të negociuar për kompanitë BE-së që nuk janë të themeluara në Kosovë. Kosova do të duhet të siguroj që legjislacioni i prokurimit publik është në përputhje me atë të BE-së. Gjithashtu do të duhet të forcoj institucionet përkatëse dhe gjyqësorin në mënyrë që procedurat e prokurimit publik të zbatohen siç duhet.

3.5.4. Standardizimi, akreditimi, vlerësimi i konformitetit, metrologjia dhe mbikëqyrja e tregut

Legjislacioni bazë për standardizimin, sigurinë e përgjithshme të produktit, kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, si dhe për akreditim është miratuar në mënyrë progresive. Këshilli Profesional për Standardizim, organi më i lartë për koordinimin dhe politikë-bërjen për standardizimin, është operacionale dhe është i përbërë nga anëtarët e të dy sektorëve, atë publikë dhe privatë. Këshilli vendos për themelimin e komiteteve teknike. Kosova gjithashtu ka një Agjencinë për Standardizim, një agjenci ekzekutive e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë

18 komisione teknike janë themeluar dhe afërsisht 4,000 standardet evropiane (EN) janë miratuar si standarde të Kosovës, duke përfshirë një numër të standardeve të harmonizuara lidhur me Direktivat e Qasjes së Re. Agjencia Kosovare për Standardizim miraton standardet nëpërmjet trupit të Standardizimit Shqiptar Kombëtar. Agjencia zbaton parimet e përfshirjes transparencës dhe llogaridhënies së kodit OBT-së të praktikës së mirë për standardizim, pavarësisht që Kosova nuk është anëtare e ndonjë organi të standardeve evropiane ose ndërkombëtare.

Drejtoria e Akreditimit e Kosovës është vendosur në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Drejtoria kryeson Këshillin Profesional për Akreditim që mbledhet një herë në vit dhe përfshin përfaqësues nga organizatat e biznesit dhe Oda Ekonomike. Drejtoria ka një kontratë bashkëpunimi me Bashkëpunimin Evropian për Akreditim (EA). Në nëntor 2010, ajo ka aplikuar për të nënshkruar një marrëveshje dypalëshe me EA sipas kushteve të zbatueshme për nënshkruarit e marrëveshjes shumëpalëshe të EA për laboratorë testues. Drejtoria e Akreditimit ka akredituar 18 laboratorë testimi dhe 1 trupë inspektuese, si organet e vlerësimit të konformitetit. Laboratorët e akredituar mbulojnë analizat e ushqimit, testimin kimik të karburantit, si dhe testimin fiziko-kimike dhe testimin mekanike të materialeve të ndërtimit.

Legjislacioni dhe politikat për vlerësimin e konformitetit hartohen dhe zbatohen nga Departamenti i Industrisë, në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Departamenti i Metrologjisë në kuadër të Ministrisë është i vetmi institucion në Kosovë, përgjegjës për krijimin dhe drejtimin e sistemit të metrologjisë në Kosovë. Dy laboratorë të vendosur në Prishtinë dhe Prizren kanë filluar funksionimin e tyre në vitin 2010.

Legjislacioni për mbikëqyrjen e tregut është pjesërisht i përafuar me *acquis*. Funksionet e mbikëqyrjes së tregut janë duke u centralizuar. Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Ministrisë ka nisur kohët e fundit

një iniciativë për të zhvilluar një strategji sektoriale për mbikëqyrjen e tregut, duke përfshirë doganat, inspektoratin e shëndetit, ushqimit dhe inspektoratin sanitar, dhe inspektoratin e punës. Përafërsisht 30.000 inspektime janë kryer që prej krijimit të Departamentit në vitin 2005.

Në përgjithësi, elemente të rëndësishme të kornizës ligjore dhe institucionale për akreditim, standardizimit dhe vlerësimin e konformitetit janë në vend. Gjatë tre viteve të fundit, kapaciteti i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në këtë fushë është përmirësuar.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, Kosova ka nevojë për të kompletuar kornizën ligjore dhe të vazhdoj përputhjen me *acquis*. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme në aspektin e ngritjes së kapaciteteve të Ministrisë dhe të agjencive të saj, të trajnimit dhe ngritjes së vetëdijes. Për shembull, kapaciteti i Agjencisë Standardizimit duhet të rritet. Operacionet e laboratorëve të metrologjisë ende nuk përmbushin standardet ndërkombëtare. Bashkëpunimi ndër-institucional për mbikëqyrjen e tregut duhet të përmirësohet, sidomos me doganat. Bashkëpunimi me doganat është vendimtar duke parë nivelin e importeve në Kosovës. Një mbikëqyrje efektive duhet të kryhet mbi produktet në dispozicion në tregun e brendshëm. Të dhënat mbi inspeksionin e tregut janë vetëm pjesërisht në dispozicion pa si që një bazë e dhënave ende nuk është themeluar.

Sipas MSA-së, Kosova do të angazhohet që në mënyrë progresive të harmonizojë legjislacionin e saj me acquis, të miratojë standardet evropiane (EN) dhe të rrit kapacitetet institucionale për të siguruar zbatimin e legjislacionit. Në veçanti, Kosova do të jetë e nevojshme për do të duhet që të i) promovoj përdorimin e rregulloreve teknike të BE-së, standardet evropiane dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit, ii) përfundojnë, kur është e përshtatshme, një marrëveshje për vlerësimin e konformitetit dhe pranimin e produkteve industriale, iii) nxis zhvillimin e cilësisë së infrastrukturës: standardizimi, metrologjia, akreditimi dhe vlerësimi i konformitetit dhe mbikëqyrja e tregut.

3.5.5. Mbrojtja e konsumatorit

Kosova ka legjislacion për mbrojtjen e konsumatorit. Ekziston edhe Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit. Kosova ka miratuar Programin për Mbrojtjen e Konsumatorit 2010-2014 i cili synon të forcojë rolin e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe aktivitetet e tij mbikëqyrëse, së bashku me transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve të përgjegjshme për konsumatorët. Këshilli është i përbërë nga përfaqësues të shoqatave të biznesit dhe organizatat për mbrojtjen e konsumatorit dhe ekspertë individual. Këshilli është organi politik kryesor dhe legjislativ.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, Kosova duhet të vazhdojë me përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit me acquis. Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit ka ende nevojë për t'u përforcuar në mënyrë të konsiderueshme për të siguruar një mbrojtje efektive të konsumatorit. Sistemi i përgjithshëm i mbledhjes dhe përpunimit të kërkesave të konsumatorit duhet të rritet për të arritur ndikim konkret dhe për të përmirësuar cilësinë e tregut dhe e sigurinë e përgjithshme të produktit. Roli i Departamentit të Mbrojtjes së Konsumatorit, është vlerësimi dhe koordinimin e informatave të mbikëqyrjes së tregut dhe të dhënave që lidhen me produktet e konsumit nuk është përcaktuar. Kosova ka nevojë të përmirësojë zbatimin e Programit për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Sipas MSA-së, Kosova do të ketë nevojë për të zhvilluar politika aktive për mbrojtjen e konsumatorit, në përputhje me acquis, për të garantuar përfaqësimin e konsumatorit, informimit dhe edukimit. Kapacitetet e strukturave administrative përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit duhet të rriten për të siguruar shëndetin thelbësor dhe kërkesat e sigurisë dhe ruajtjen e interesave të konsumatorëve ekonomike.

3.6. Drejtësia dhe çështjet e brendshme

3.6.1 Fuqizimi i institucioneve dhe sundimi i ligjit

Për një analizë të hollësishme të situatës në gjyqësor dhe sistemin e burgut shihni tek Kriteret Politike

Elementet kryesore të kornizës ligjore janë të vendosura mirë .Në të njëjtën kohë ato mund të jenë komplekse, të përbëra nga një përzierje e akteve të ndryshme ligjore të aplikuara në Kosovë duke përfshirë legjislacionin e ish Jugosllavisë dhe ish-Republikës Federale të Jugosllavisë, UNMIKU-t si dhe autoriteteve Kosovare. Kjo ka dërguar në mospërputhjet ligjore. Aplikimi në nivelin e gjykatës rrjedhimisht krijon vështirësi dhe vonesa .Ka përpjekje të vazhdueshme për të eliminuar copëzimin dhe rritur për afrimin me BE-në në këtë fushë të rëndësishme.

Gjate tri viteve të fundit, Kosova ka themeluar institucionet e nevojshme përgjegjëse për sundimin e ligjit në Kosovë. Ministria e Punëve të Brendshme mbikëqyr punën e Policisë së Kosovës, me një staf total prej 8500 vetash (duke përfshirë 1100 zyrtarë civilë).Personat që u përkasin pakicave zënë 13% të pozitave. Policia e Kosovës ka krijuar kapacitete të mira për ofrimin e sigurisë së përgjithshme dhe sigurisë publike.

Policia e Kosovës operon me një zinxhir të vetëm komandues dhe vazhdon të ketë një prezencë të vogël në veriun e Kosovës. Ka kanale komunikimi në mes të zyrtarëve nga komunat veriore me komandën e policisë rajonale në pjesën jugore të Mitrovicës. Në të njëjtën kohë, EULEX-it shpeshherë i duhet të mundësojë komunikimin. Zyrtarët policor në veri të Kosovës punojnë në rrethana të vështira që i parandalon ata në plotësimin e detyrave të tyre. Strukturat paralele të sigurisë gjithashtu operojnë në veri.

Në vitin 2011 Policia themeloi Njësitin për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Zbatim të Ligjit (ILECU) për të mundësuar bashkëpunimin me agjencitë për zbatimin e ligjit nga vendet e treta. Zyra ndërlidhëse e Interpolit është ende me UNMIK-un ;disa policë të Kosovës i janë bashkangjitur kësaj njësie .

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është themeluar në Qershor të vitit 2011 si një organ ekzekutiv i Ministrisë së Punëve të Brendshme i pavarur nga Policia e Kosovës. IPK-ja trajton ankesat si dhe përfshinë Njësinë e Standardeve Profesionale aty ku paraqitet nevoja për një hetim disiplinor, dhe ka autoritetin që të fillojë hetimet penale.

Kapacitetet e Policisë së Kosovës për të hetuar aktivitetet e ndërlikuara kriminale mbeten të kufizuara dhe duhet të rriten në mënyre të konsiderueshme. Udhëheqësit politikë në Kosove duhet të krijojnë një mjedis të favorshëm për hetime të pavarura dhe profesionale.

Mbrojtja e të dhënave personale është një komponent kyç i bashkëpunimit efektiv në zbatimin e ligjit në BE. Kosova ka miratuar kornizën primare legjislative për mbrojtjen e të dhënave personale. Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është themeluar si një organ i pavarur që i raporton Kuvendit. Aktualisht mbrojtja e të dhënave personale nuk është e garantuar plotësisht. Kosova duhet të përqendrohet më tepër në zbatimin, hartimin e legjislacionit dytësor dhe forcimin e kapaciteteve. Autoritetet publike,duke përfshire zbatimin e ligjit dhe sektorin privat duhet të jenë të vetëdijshme për kërkesat e mbrojtjes së të dhënave personale.

Që Kosova të ketë progres në konsolidimin e sundimit të ligji, është thelbësore që të bashkëpunojë me EULEX-in dhe të mbështesë zbatimin e mandatit të EULEX-it duke përfshirë Task Forcën Hetimore Speciale të EULEX-it. Fragmentimi i legjislacionit duhet të adresohet në mënyrë të duhur si dhe të përmirësohet zbatimi i ligjit në mënyrë që të sigurohemi se sundimi i ligjit aplikohet në mënyrë efektive.

Sipas MSA-së palët kontraktuese do të kushtojnë rëndësi të veçante sundimit të ligjit në Kosovë si dhe forcimit të institucioneve përkatëse të administratës në përgjithësi dhe zbatimin të ligjit dhe gjyqësorit në veçanti. Një MSA efektive do të varet nga një hapësirë e sigurt, efikase dhe e parashikueshme ligjore. Autoritetet dhe një gjyqësor i pavarur që punojnë në përputhje me standardet demokratike dhe profesionale janë jo vetëm të domosdoshme për vendosjen e sundimit të ligjit dhe jo vetëm për përfitimin e menjëhershëm të popullatës por edhe për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe si rrjedhojë edhe zhvillimit ekonomik duke përfshirë tërheqjen e investitorëve të huaj. Palët kontraktuese do të bashkëpunojnë në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale duke siguruar burime të mjaftueshme për organin e

pavarur mbikëqyrës dhe garantimin e zbatimit të legjislacionit.

3.6.2 Azili migrimi, politika e vizave, kontrolli i kufijve/ kufijve administrativ

Sistemi i ri i *azilit* u themelua në prill të vitit 2011-të. Kosova ka një ligj gjithëpërfshirës për azilin. Departamenti i shtetësisë, azilit dhe migrimit (DSHAM) në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjegjës për politikën e azilit. Kosova është kryesisht një vend transit për azilkërkuesit dhe emigrantët jo të rregullt që kryesisht arrijnë nëpërmjet ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe vazhdojnë për në BE. Autoritetet Kosovare kanë ndërmarrë hapa për të ngritur ndërgjegjësimin për të drejtat dhe detyrimet e azil kërkuesve. DSHAM-ja është në krye të vendimeve të shkallës së parë ndërsa Komisioni Kombëtar për Refugjatë është në krye të vendimeve të shkallës së dytë. Midis vitit 2009 dhe muajt Korrik të vitit 2012, 511 kërkesa për azil janë përpunuar, me ç'rast asnjëra prej tyre nuk ka rezultuar në statusin e refugjatit të njohur. Shumica e vendimeve lidhur me kërkesat për azil janë vendime negative në mungesë (ku azilkërkuesi tashmë është larguar nga Kosova). Një qendër e re azili në komunën e Lipjanit është inauguruar në Shkurt të vitit 2012 duke bërë përmirësimin e objekteve të banimit për azilkërkuesit në Kosovë.

Kosova ka një strategji dhe plan veprimi mbi migrimin. Këto janë aktualisht në shqyrtim. Korniza ligjore për të huajt dhe shtetësinë është e vendosur mirë. Një fushatë e informimit publik mbi migrimin jo të rregullt nga Kosova në BE u mbajt në vitin 2011. Kosova ka bërë *përparime të shumta mbi ri-pranimin* gjatë tre viteve të fundit. Ligji për ri-pranim është miratuar në vitin 2010. Marrëveshjet e ri-pranimit që përfshijnë shtatëmbëdhjetë vende janë konkretizuar. Që nga viti 2010 Kosova ka bërë përparim të konsiderueshëm në përmirësimin e kornizës për ri-integrimin e personave të riatdhesuar. Një strategji dhe një plan veprimi për ri-integrimin ka vendosur prioritetet në këtë fushë. Fondi për ri-integrimin *e personave të riatdhesuar* është themeluar në vitin 2010. Zyra për ri-integrim në aeroportin e Prishtinës është pika e parë hyrëse për personat e riatdhesuar. Në 2012 shtatë koordinatorë rajonal janë emëruar si pika kyçe në komuna me qëllim të përmirësimit të komunikimit ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal.

Politika e Kosovës për viza duhet të hyjë në fuqi më 1 Janar të vitit 2013. Kjo do të krijojë një liste të qytetarëve të cilët duhet të jenë në posedim të vizës për të hyrë në Kosovë. Në këtë kontekst Kosova ka nënshkruar një marrëveshje me Shqipërinë për përfaqësim konsullor. Banorët e Kosovës kryesisht përdorin pasaportat e Kosovës që janë futur në përdorim në vitin 2008 edhe pse disa prej tyre përdorin pasaporta biometrike serbe. Kosova ka filluar lëshimin e pasaportave biometrike në Tetor të vitit 2011.

Një kornizë ligjore për gjendjen civile është kryesisht e vendosur. Një pjesë e legjislacionit dytësor ende ka nevojë të kompletohet. Që nga viti 2011 njësia e Inspektoratit të Agjencisë për Regjistrim Civil (ARC) ka bërë kontrollimin e integritetit të proceseve të lidhura me gjendjen civile. Janë miratuar masa për të parandaluar zyrtarët komunal të gjendjes civile në lëshimin e paligjshëm të të dhënave personale pa lejen paraprake. Librat e gjendjes civile janë digjitalizuar dhe do të futen në bazën e re qendrore të gjendjes civile. Kopje të certifikuara të librave amë të regjistrimit civil për territorin e Kosovës dhe që gjinden në Serbi janë në proces të dorëzimit tek autoritetet Kosovare duke u mbështetur në marrëveshjen e mundësuar nga BE-ja të dialogut Prishtinë–Beograd.

Korniza ligjore dhe Institucionet e Kosovës (Policia Kufitare, Doganat e Kosovës, si dhe Agjencia Kosovare e Ushqimit dhe Veterinës) në sigurimin e kufijve/kufirit administrativ të Kosovës janë kryesisht të rregulluara mirë. Ekziston edhe një strategji dhe një plan veprimi *për menaxhimin e kufijve dhe të kufirit administrativ*. Policia ka marrë përsipër përgjegjësinë nga KFOR-i për mbikëqyrjen e kufirit me Malin e Zi dhe ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Patrullime të përbashkëta kufitare janë kryer në baze të marrëveshjes me Shqipërinë dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Për të mbushur obligimet e saj sipas MSA-së Kosova duhet të vazhdojë me përafrimin e mëtutjeshëm të legjislacionit me *acquis* dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse në këto fusha. Ligji mbi azilin ka nevojë të përafrohet më tej me linjën ndërkombëtare dhe standardet e BE-së. Mungesa e informacioneve në lidhje me origjinën e azilkërkuesve dhe mungesa e dokumenteve të identitetit janë pengesa për largimin e azilkërkuesve të cilëve u është refuzuar kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare. Është

e nevojshme të miratohen procedura zyrtare operuese për largimin e azil kërkuarve. Udhëzime të nevojshme administrative dhe procedura standarde të veprimit mbi *migrimin* duhet të miratohen më tej. Legjislacioni i Kosovës në këtë fushë bie ndesh me legjislacionin mbi lejen e punës. Me këtë duhet të merremi ende. Zgjidhje të qëndrueshme janë të nevojshme për gjendjen e personave të zhvendosur (duke përfshirë qasjen në dokumentet personale të identifikimit), kushtet për ribashkim familjar, lejet e qëndrimit për azil kërkuar, refugjatët dhe personat nën mbrojtjen subsidiare, personat pa nënshtetësi, viktimat e trafikimit, si dhe për njerëzit që me kërkesë të tyre janë liruar nga nënshtetësia e Kosovës.

Një mekanizëm gjithëpërfshirës për mbledhjen e të dhënave nuk është ende në fuqi por baza e të dhënave për azil dhe migrim pritet të kontribuojë në mbledhjen e të dhënave dhe analizimin e tyre pasi që të aplikohet në mënyrë efektive. Duhet të zhvillohet një profil migrimi për Kosovën. Koordinimi ndërinstytucional duhet të shtohet dhe gjithashtu duhet të përmirësohen kapacitetet administrative.

Kërkesat në pritje të ri-pranimit janë bërë kryesisht për shkak të sfidave në verifikimin e identitetit dhe përcaktimit të nënshtetësisë si dhe vonesave në komunikimin e përgjigjeve negative. Bashkëpunimi në ri-pranim ndërmjet autoriteteve të ndryshme duhet të përmirësohet. Afatet e përcaktuara në marrëveshjet dhe ligjet e ri-pranimit duhet të zbatohen. Shkëmbimi i informacioneve ndërmjet shteteve kërkuar dhe Kosovës duhet të forcohet. Mungesa e marrëveshjeve të ri-pranimit me vendet e origjinës apo transitit dhe mungesa e zbatimit të ligjit për ri-pranim është gjithashtu një brengë.

Numri i kërkesave për të ndihmuar fondin për ri-integrim është në rritje. Në përgjithësi shpagimi mbetet i ulët në përgjigjen ndaj kërkesave individuale. Skemat e punësimit dhe projektet e strehimit për të cilat një pjesë e madhe e buxhetit është ndare janë në një fazë të hershme të zhvillimit.

Pasi që fondi i ri-integrimit sigurohet prej buxhetit shtetëror edhe vendimet për shpagim financiar bëhen në nivelin qendror. Zyra për ri-integrim e cila menaxhon kërkesat për financim do të ngritet në departament të MPB-së. Ky departament duhet të marre përsipër vendimet e marra nga aktualisht Bordi Ekzekutiv Ndërmnistror për integrim. Procedurat për kërkimin e fondeve duhet të thjeshtëzohen edhe më tej.

Sistemi i menaxhimit të rasteve parashikohet ti ndihmojë më tutje autoriteteve në përpunimin dhe qasjen në të dhënat e personave të riatdhesuar në mënyrë që të plotësohen kërkesat e tyre më mirë. Kontaktet mes nivelit qendror dhe atij komunal duhet të shtohen. Përfshirja e Ministrive të linjës në procesin e ri-integrimit mbetet e dobët sidomos në arsim, punësim dhe trajnim. Mungesa e qasjes në punë, arsimim dhe trajnim vazhdon të jetë një pengesë për një ri-integrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar e në veçanti pjesëtarëve të minoriteteve.

Në lidhje me vizat udhëzimet administrative ende duhet të miratohen. Sa i përket sigurisë së dokumenteve në këtë drejtim ekzistojnë shqetësime sa i përket saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave të gjendjes civile si në nivelin qendror ashtu edhe në komuna. Mungesa e sigurisë së dokumenteve mund të bie ndesh me besueshmërinë e dokumenteve të reja biometrike. Kosova gjithashtu duhet të rrisë mbrojtjen e kufijve /kufirit administrativ në mënyrë që të parandalojë trafikimet e shpeshta.

Sipas MSA-së, Kosova do të ketë nevojë që të sigurojë një kornizë për bashkëpunim, duke përfshirë nivelin rajonal, në fushën e vizave, kontrollit të kufirit/vijës kufitare, azilit dhe migrimit (të ligjshëm dhe jo të rregullt). Një element qendror i bashkëpunimit në fushën e parandalimit dhe kontrollit të migrimit të parregullt do të jetë përfshirja e dispozitave për ri-pranim dhe përqendrimi në shkëmbimin e statistikave dhe shtimit të efikasitetit dhe kapaciteteve.

3.6.3 Luftimi i shpëlarjes së parave

Një kornizë ligjore kundër shpëlarjes së parave është e vendosur, por ende nuk është në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Kosova aktualisht është duke rishikuar legjislacionin e saj për të përfshirë dispozitat e legjislacionit të BE-së si dhe rekomandimit të Task Forcës për Veprime Financiare. Kjo duhet të jetë prioriteti i Kosovës në një kohë afat shkurte. Gjithashtu kjo është edhe një parakusht për t'iu bashkuar Grupit Egmont të Njësisë të Inteligjencës Financiare (NJIF). NJIF-i ka iniciuar procedurat për t'iu bashkuar këtij grupi dhe ka kërkuar nga NJIF-ja Sllovene që të jetë sponsori i saj.

Institucionet përkatëse janë themeluar dhe janë funksionale. Përgjegjësitë e qendrës së inteligjencës financiare të udhëhequr nga EULEX-i kohët e fundit janë bartur në NJIF që i është bashkangjitur Ministrisë së Financave. NJIF-ja nuk kryen vetëm hetimet kriminale por i ofron informata inteligjente organeve hetuese. Bashkëpunimi me banka është i mirë dhe një sistem i transaksioneve të parave është funksional: mbi 420,000 transaksione me vlerë mbi 10,000 € janë raportuar në NJIF çdo vit. Ky është një numër i lartë në krahasim me madhësinë e popullsisë së Kosovës dhe ekonomisë së saj. Doganat e Kosovës kanë pasur një ngritje në zbulimin e të hollave. Shuma totale e parave të zbuluara të cilat nuk ishin deklaruar është ngritur. Gjithashtu ka pasur një ngritje në numrin e deklarimeve të hollave në të njëjtën periudhë. Në një afat të shkurtër Kosova ka nevojë të rishikojë ligjin për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, Kosova duhet të përgatis një strategji të luftimit të pastrimit të parave. Rregullimi institucional, përfshirë drejtoritë dhe njësitë e ndryshme policore, NJIF-it, dhe Task Forcës Kundër Korrupsion të Prokurorisë Speciale është i ndërlikuar. Ai duhet të thjeshtëzohet në mënyrë që të trajtojë me efikasitet shpëlarjen e parave. Zyrtarët e policisë, prokurorët dhe gjyqtarët kanë nevojë për trajnim të specializuar në mënyrë që të udhëheqin hetimet e ndërlikuara. NJIF-i ka nevojë që të përmirësojë kapacitetet e saj analitike në mbështetje të hetimeve. Kosova ka nevojë të përmirësojë statistikën e saj në këtë fushë. Për më tepër shuma të mëdha parash vazhdojnë të investohen për shembull në pasuri të patundshme pa mbikëqyrjen e duhur dhe NJIF-i nuk është i mandatar ligjshëm të kryejë inspektime të kazinove.

Bashkëpunimi ndërkombëtar që përfshin Kosovën në këtë fushë është i limituar. Kosova nuk është një anëtare e Task Forcës për veprim Financiar (TFVF) apo e ndonjë organi rajonal të TFVF-ve të llojit të tillë. Një numër i NJIF-ve Evropiane aktualisht refuzojnë të përgjigjen informatave inteligjente apo edhe kërkesës së NJIF-it Kosovës për informata të tilla. Në të njëjtën kohë Kosova ka nevojë të zbatojë rekomandimet e TFVF-ve ekzistuese.

Sipas MSA-së Kosova do të ketë nevojë që të krijojë një kornizë për bashkëpunim me qëllim të parandalimit të përdorimit të sistemeve financiare për shpëlarjen e parave dhe përdorimin e tyre në aktivitete kriminale.

Bashkëpunimi në këtë fushë do të përfshijë asistencën teknike dhe administrative me qëllim të vendosjes së standardeve të duhura për t'iu kundërvënë pastrimit të parave dhe që janë në përputhje me standardet e miratuara nga BE-ja dhe organet tjera ndërkombëtare në këtë fushë e në veçanti të TFVF-ve.

3.6.4. Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe aktiviteteve tjera kriminale, duke përfshirë terrorizmin

Përgjatë tri viteve të fundit, Kosova ka themeluar elementet kyçe të kornizës ligjore të nevojshme për luftën kundër krimit të organizuar. Kosova ka gjithashtu legjislacionin për mbrojtjen e dëshmitareve dhe ka themeluar një njësi përkatëse të policisë. Kosova ka një kornizë strategjike për luftën kundër krimit të organizuar, drogës dhe terrorizmit; ku strategji të reja dhe të rishikuara janë miratuar kohëve të fundit. Kosova ka një strategji dhe një plan veprimi në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme është edhe një koordinator kombëtar për luftën kundër trafikimit i cili është në krye të zbatimit të aktiviteteve të koordinuara. Ekziston gjithashtu edhe një kornizë politike për një inteligjencë të udhëhequr nga policia.

Institucionet përkatëse për luftën kundër krimit të organizuar, sidomos autoritetet për zbatimin e ligjit dhe gjyqësorit janë themeluar dhe kanë rritur kapacitetet dhe efikasitetin e tyre gjatë tre viteve të fundit. Kosova së fundmi ka krijuar strukturat policore për bashkëpunim ndërkombëtar me theks të veçantë në krijimin e Njësisë ndërkombëtare për bashkëpunim dhe zbatim të ligjit. Një agjenci për administrimin pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara është krijuar në vitin 2010. Kjo agjenci është kryesisht përgjegjëse për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Në afat të shkurtër Kosovës i duhet të përqendrohet në miratimin e legjislacionit të ri për konfiskimin e pasurive të fituara në mënyrë të

paligjshme. Është e rëndësishme që ligji ti ndjek standardet dhe praktikat Evropiane në këtë fushë.

Për ti përmbushur obligimet veta sipas MSA-së Kosova ka nevojë për të kryer më tepër hetime dhe ndjekje të krimit organizuar. Ajo gjithashtu ka nevojë të përmirësojë edhe statistikat në këtë fushë.

Një rrjet i konsiderueshëm i krimineleve shqipfolës duke përfshirë edhe Kosovarët janë mjaft të përfshirë në kontrabandën e drogave, përfshirë heroinën dhe kokainën si në rajon ashtu edhe në BE. Gjatë tre viteve të fundit niveli i konfiskimit të drogës në Kosovë është rritur. Në të njëjtën kohë duhen të behën përpjekje të mëtejshme për të përmbushur sfidat, në veçanti ato në lidhje me arrestimet dhe dënimet.

Kosova mbetet një vend origjine dhe transiti, për viktimat e trafikimit. Tendenca për trafikimin e grave vendore brenda Kosovës dhe më pas në shtetet Evropiane për qëllim të shfrytëzimit seksual është në vazhdim e sipër. Ka një rritje të numrit të viktimave të mitura që trafikohen për shfrytëzim seksual. Trafikimi i fëmijëve për qëllime të shfrytëzimit të tyre për lypje mbetet në nivel shumë të lartë. Aeroporti i Prishtinës vazhdon të mbetet një pikë e dobët në këtë drejtim. Numri i dënimeve në këto fusha është i vogël. Mungesa e ekspertizës dhe kapaciteteve në prokurori dhe gjyqësor rezultojnë në llogaridhënie të dobët për shkelësit e trafikimit në këtë fushë. Një financim i duhur i qeverisë për strehimore dhe ri-integrimin e viktimave është i nevojshëm.

Deri më sot terrorizmi ka qenë një kërcënim më i vogël në Kosovë në krahasim me llojet tjera të krimeve të rënda. Kosova gjithsesi ka nevojë që gradualisht të sigurohet që korniza dhe strategjia e saj legislative të jetë në një linjë me BE-në. Autoritetet e zbatimit të ligjit në Kosovë duhet të vazhdojnë monitorimin e situatës.

Bashkëpunimi ndërkombëtar me Kosovën në luftën kundër krimit të organizuar është i kufizuar për shkak të çështjeve të statusit. Kosova duhet të jetë më pro-aktive dhe më pragmatike në këtë fushë. Mbi të gjitha Kosova ka nevojë që gradualisht të rrisë kredibilitetin e saj dhe kështu edhe besimin partnereve të saj ndërkombëtar.

Mbrojtja e dëshmitarëve në Kosovë është një sfidë veçanërisht e vështirë. Legjislacioni dytësor në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve mbetet për tu miratuar. Kapaciteti i Njësisë për mbrojtjen e dëshmitarëve në kuadër të Policisë së Kosovës duhet të rritet edhe më tej. Mbështetja e mëtejshme politike dhe në veçanti një autonomi buxhetore për njësinë është më se e nevojshme që ajo të behet plotësisht operative.

Kosova ka nevojë për krijimin e një kornize të shëndoshë ligjore për përgjimin e telekomunikacionit. Duhet të bëhet një dallim i qartë në mes të përgjimit gjyqësor dhe përgjimit për qëllime të inteligjencës në përputhje me praktikën më të mira evropiane. Mekanizma të përshtatshëm të kontrollit duhet të vendosen për tu siguruar që këto mjete nuk do të keqpërdoren.

Agjencia për menaxhimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara ka arritur të menaxhojë vetëm një numër të vogël të pasurive për shkak të numrit të ulët të konfiskimeve dhe sekuestrimeve që janë urdhëruar nga gjyqësori dhe që janë ekzekutuar nga policia. Gjyqësori duhet t'i përdorë dispozitat mbi konfiskimin në mënyrë më aktive. Zbatimi i inteligjencës së udhëhequr nga policia mbetet një sfidë.

Në përgjithësi lufta kundër krimit të organizuar është një sfidë madhore për Kosovën. Dëshmitarë konkretë dhe rezultateve në luftimin e krimit të organizuar duhet tu jepet prioritet. Për të arritur rezultate në këtë fushë korniza ligjore duhet të fuqizohet dhe zbatohet më tej. Përgjegjësitë e qarta institucionale duhet të rregullohen. Kosova ka nevojë që të rrisë më tej nivelin e ekspertizës për të trajtuar hetime të ndërlikuara penale. Kjo duhet të mbështetet nga një mjedis i përshtatshëm politik për hetime efikase dhe të pavarura si dhe ndjekjes penale.

Sipas MSA-së Kosova do të ketë nevojë të zhvillojë një kornizë për bashkëpunim me qëllim të synimit të parandalimit dhe luftimit të aktiviteteve kriminale, sidomos krimit të organizuar. Kosovës do t'i kërkohet që t'ij kushtojë vëmendje të veçante çështjeve të tilla si: trafikimi i qenieve njerëzore, aktiviteteve të paligjshme ekonomike (siç janë korrupsioni dhe transaksionet e paligjshme që përfshijnë mallrat si: prodhimet e falsifikuara, mbeturinat industriale dhe materiali radioaktiv) trafikimi i ndaluar i armëve dhe terrorizmi. Kosova gjithashtu duhet të jetë e gatshme të përballet me shëndetin dhe pasojat sociale të abuzimit me

drogë , parandalimin e diversioneve në stabilimentet kimike dhe të përforcoje strukturat e veta në luftën kundër trafikimit të drogës.

3.7. Politikat e Bashkëpunimit

3.7.1. Bashkëpunimi ekonomik, monetar, statistikor dhe mbrojtja e interesave financiare të BE-së

Ministria e Financave ka një departament për analiza makro ekonomike dhe fiskale i cili është aktiv në planifikimin strategjik dhe ekonomik të Qeverisë. Departamenti është përgjegjës për përgatitjen e Kornizës afatmesme makro fiskale (KASH) që paraqet themelin e hartimit të kornizës së shpenzimeve si dhe analizon trendët aktual fiskal dhe parashikimet ekonomike. KASH-i përfshin shume karakteristika që janë të zakonshme në praktikën ndërkombëtare si dhe një bazë premtuese për analiza sektoriale. Kosova ka një kërkesë ligjore për të kryer një vlerësim të ndikimeve fiskale të gjitha politikave të reja dhe propozimeve legjislative. Kosova aktualisht merr pjese në ushtrimin e vëzhgimit fiskal.

Statistikat janë vendimtare për negocimin e MSA-së. Në vitet e fundit Kosova ka përmirësuar infrastrukturën e saj statistikore. Me miratimin e fundit të ligjit për statistikën zyrtare përgjegjësia kryesore për përpunimin e të dhënave statistikore bie mbi Agjencinë Kosovare të Statistikave (ASK). Agjencia është zhvendosur nga Ministria e administratës publike në zyrën e kryeministrit. Ajo tani është një organizatë me buxhet të pavarur. Gjithashtu një këshill statistikor është themeluar në Mars të vitit 2012. Sipas ligjit të ri për hartimin e një plani shumë vjeçar të punës për sistemin statistikor të Kosovës.

Bashkëpunimi i agjencisë me institucionet tjera është përmirësuar. Gjithashtu edhe cilësia e informacionit statistikor gradualisht është përmirësuar.

Regjistrimi i popullsisë dhe banesave është kryer në prill të vitit 2011, por nuk ka përfshirë edhe veriun e Kosovës. Shifrat që kanë dalë nga regjistrimi janë të besueshme. Përgatitjet për regjistrimin bujqësor për vitin 2013 kanë filluar.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së KASH-i duhet të përfshijë një numër të aspekteve që janë praktike në shume shtete të BE-së duke përfshirë: i) Krahësimin me parashikimet e institucioneve të tjera dhe parashikimit të ish Ministrisë së Financave ,ii) shpenzimet e taksave,iii) borxhi publik dhe deficitin i zbërthyer në nivele të qeverisjes. KASH-i gjithashtu duhet të zhvillohet plotësisht si një mjet raportues apo i politikave.

Ministritë duhet të forcojnë kapacitetet e tyre për të përgatitur vlerësimet e duhura të kostove. Praktika e miratimit të një numri shumë të madh të ligjeve drejt përfundimit të vitit nuk është i favorshëm për analiza të sakta dhe ndikim të kostos.

Kosova gjithashtu duhet të vazhdojë të përgatitet për pjesëmarrjen në kornizën ekonomike dhe fiskale të shteteve kandidatë potenciale. Përfshirja e Kosovës në këtë kornizë mund të sjellë përfitime në riorganizimin, koordinimin dhe analizimin e politikave ekonomike me prioritet afatmesëm.

Sa i përket statistikave, kapaciteti administrativ i agjencisë statistikore mbetet i dobët dhe mungesa e personelit të kualifikuar është një pengesë serioze në zhvillimin e agjencisë. Fuqizimi i menaxhmentit të agjencisë mbetet një element kyç për zhvillimin e institucionit dhe sistemit statistikor të Kosovës. Agjencia ka nevojë që të përmirësojë cilësinë e statistikave në të gjitha fushat statistikore e sidomos atë të biznesit dhe statistikave makro ekonomike. Mospërputhja e tanishme në mes të dhënave statistikore të BE-së dhe Kosovës përbën një sfidë në vete. Bashkëpunimi efektiv në bazë të MSA-së do të kërkonte nga AKS-ja që të nxjerrë të dhëna për makro çështjet ekonomike siç janë tregtia dhe punësimi.

Mbrojtja e interesave financiare të BE-së dhe mbrojtja e Euros nga falsifikimi është ende në një fazë të hershme.

Sipas MSA-së Kosova do të ketë nevojë për të nxitur integrimin e reformave ekonomike në strukturat Evropiane duke përmirësuar formulimin dhe zbatimin e politikave të bazuara në treg. Ajo do të ketë nevojë të përmirësojë kapacitetin e saj për të siguruar informata mbi ecurinë dhe parashikimet makroekonomike në mënyrë që të formulojë politiken e saj ekonomike dhe të zhvillojë instrumentet e nevojshme për aplikimin e saj. Gjithashtu ajo duhet të ketë parasysh edhe zhvillimin e politikave të saj si dhe unionit ekonomik dhe monetar të Evropës. Kosovës do ti duhet të zhvillojë sistemet statistikore të afta për të dhënë në kohë të dhëna të besueshme, objektive, të sakta dhe në kohë të duhur që nevojiten për planifikimin dhe mbikëqyrjen e tranzicionit dhe reformave. Vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet faktit se Kosova përdor Euron si tenderin e saj ligjor. Përdorimi i pranishëm i Euros në Kosovë si tender ligjor ndryshon plotësisht nga anëtarësimi në Euro zonë. Me një kujdes të veçantë në mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe luftën kundër falsifikimit të Euros, bashkëpunimi do të përqendrohet gjithashtu edhe në forcimin e mëtejshëm të kornizës legjislative dhe zbatimit të saj.

3.7.2. Nxitja dhe mbrojtja e investimeve, bashkëpunimi industrial, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) dhe turizmi

Fusha për promovimin dhe mbrojtjen e investimeve është e rregulluar me ligjin për të huajt. Investimi duhet që të fokusohet ndër të tjera në trajtimin jo diskriminues të investitorëve të huaj. Gjatë tri viteve të fundit disa amendamente të tilla si eliminimi i kapitalit fillestar dhe ulja e numrit të lejeve të nevojshme janë miratuar. Kosova ka miratuar gjithashtu edhe një strategji përkrahëse për investimet sektoriale që përfshin rekomandime dhe veprime operative për përmirësimin e biznesit dhe klimës së investimeve me të cilën përballen investitorët e huaj.

Strategjia identifikon sektorët kryesorë që synohen nga aktivitete promovuese: Procesi i biznesit me burim të jashtëm, komponentëve automobilistike, kontratat e shërbimeve prodhuese të komunikimeve elektronike dhe agrobiznesit.

Agjencia për promovimin e investimeve është institucioni kryesor që përqendrohet në përpjekjet për të tërhequr investimet e huaja direkte (IDH). Ajo është duke bërë përpjekje për të tërhequr IDH-të me anë të liberalizimit të mëtejshëm të regjimit të hyrjeve si dhe promovimin e NVM-ve në konkurrencë. Hyrjet neto të FDI-ve janë vlerësuar të kenë arritur 394.6 milion € (8.6% e PBB-se) në vitin 2011 pak më lart se 365.8 milion €.

Kosova është përkushtuar në zbatimin e parimeve kyçe të dokumentit të BE-së për biznesin e vogël. Sektori i ndërmarrjeve të vogla në Kosovë është mjaft i madh dhe i dominuar nga ndërmarrjet e vogla ku më shumë se 90% e ndërmarrjeve kanë të punësuar më pak se katër persona. Korniza legjislative përbëhet kryesisht nga ligji për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Në vitin 2011, Kosova ka miratuar strategjinë e NVM-ve për zhvillim kombëtar për vitet 2012-2016 dhe vizionin e saj deri me 2020. Agjencia e Ndërmarrjeve të vogla është institucioni kryesor që është përgjegjës për miratimin e strategjive të fondeve prej 1.3 milion € dhe 30 milion € nga komuniteti i donatorëve.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, Kosovës i duhet ende për të krijuar kushte të qëndrueshme, të parashikueshme dhe transparente për investitorët e huaj. Tërheqja e IDH-ve është një sfidë madhore për Kosovën. Ajo ka tërhequr vetëm një numër të vogël të investimeve direkte të huaja që ka mbetur në 8.5% të PBB-së. Investimet e huaja më shumë janë përqendruar në shërbime dhe sektorin financiar, me vetëm pak investime në terrenet e gjelbra.

Kosova ka nevojë të bej thjeshtëzimin dhe rishikimin e legjislacionit të politikave për ndërmarrjet. Nuk ka pasur asnjë analizë me ndikim rregullator. Kostot e pajtueshmërisë mbeten të larta. Mungesa e informacionit të plotë, qasja e lehtë dhe e përditësuar në mënyrë të rregullt e informacionit për çështjet e rëndësishme është një pengesë e rëndësishme për NVM-të që veprojnë në Kosovë. Mbështetja për bizneset fillestare mbetet veçanërisht e pazhvilluar. Të katër inkubatorët ekzistues janë ende në një pilot-fazë dhe skema "voucher" u ndërpre në vitin 2011. Kosovës i duhet që të vë në linjë mbështetjen e saj për NVM-të me Deklaratën Evropiane për Biznes të Vogël dhe të përmirësojë klasifikimin e ndërmarrjeve. Një fond i veçantë për mbështetjen e NVM-ve ndërmarrëse gjithashtu do të lehtësonte qasjen e NVM-ve në financa.

Industria dhe zhvillimi i NVM-ve në përgjithësi vazhdon të ketë vështirësi në zbatimin ligjor të kontratave, furnizimin jo të sigurt me energji dhe qasje të kufizuar dhe të shtrenjtë në financa. Koordinimi dhe komunikimi midis institucioneve arsimore dhe NVM-ve është përmirësuar. Megjithatë, koordinimi dhe bashkëpunimi duhet të rritet me to sidomos në fushën e ndërmarrjes dhe politikës industriale, (autoritetet publike, dhoma e tregtisë, shoqatat bankare, gjykatat, agjencitë rajonale të zhvillimit, etj.). Në përgjithësi plani i zbatimit për NVM-të dhe strategjitë industriale duhet të miratohet, një buxhet adekuat të jepet dhe autoritetet përgjegjëse të forcohen më tutje.

Spektori jozyrtar i Kosovës është i mbushur me të meta në politikën e taksave dhe shpenzimeve si dhe në zbatimin e ligjit, që përfshihet në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kjo gjë zvogëlon bazat tatumore dhe efikasitetin e politikave ekonomike.

Turizmi ka gjithashtu një potencial për të kontribuar në rritjen ekonomike. Megjithatë kërkohet një investim përkatës në infrastrukturë.

Bashkëpunimi sipas MSA-së do të synojë të mbështesë Kosovën në krijimin e një klime të favorshme për investimet private si vendase ashtu edhe të huaja për të promovuar ri-vitalizimin ekonomik dhe industrial. Në veçanti Kosovës do ti duhet të vazhdojë edhe në krijimin e një kornize ligjore me mundësi të favorshme për investime dhe nxitjen e tyre. Në fushën e bashkëpunimit industrial, NVM-ve dhe turizmit, Kosova do të duhet të zhvillojë politika që kanë për synim nxitjen e modernizimit dhe ristrukturimit, si dhe forcimin e sektorit të NVM-ve dhe zhvillimit të turizmit.

3.7.3. Bujqësia

Sa i përket bujqësisë dhe zhvillimit rural një numër i ligjeve tematike është i rregulluar ose janë në proces të miratimit (që mbulon .p.sh vëren, bagëtinë, farën dhe bujqësinë organike) të cilat janë gjerësisht në përputhje me *acquis*. Vendimet juridike për sigurinë ushqimore, veterinarinë dhe fito-sanitare janë në vend, sidomos ligji për ushqimin, ligji i veterinarisë, ligji për mbrojtjen e bimëve dhe udhëzimet administrative që dalin nga pakoja e BE-së për higjienë.

Gjatë tre viteve të fundit sektori i bujqësisë në Kosovë ka krijuar organet e nevojshme administrative dhe rregullative për të zbatuar *acquis* në këtë fushë. Spektori qeverisës nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural (MBPZHR). Ministria drejton një numër të skemave mbështetëse që menaxhohen nga departamenti i pagesave. Ajo gjithashtu ka filluar me zhvillimin e një regjistrimi të bujqve dhe parcelave dhe ka thjeshtëzuar sistemin e identifikimit për të kontribuar në identifikimin e tokave dhe për të mbikëqyrur skemat aktuale të grandeve rurale. Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit në Kosovë zbaton kërkesat e sigurisë ushqimore dhe ato të sigurisë ushqimore të BE-së, shëndetit të kafshëve dhe standardeve shëndetësore të bimëve. Ashtu si Ministria edhe Agjencia është një organ profesional dhe i motivuar. Në këtë fushë kemi gjithashtu edhe një numër të laboratorëve dhe instituteve. Shumica e standardeve evropiane për peshkim nuk zbatohen në Kosovë pasi që ajo nuk ka peshkim detar.

Për të përmbushur obligimet veta sipas MSA-së, Kosova duhet të vazhdojë në veçanti me përpjekjet për zbatimin e standardeve të sigurisë ushqimore të BE-së. AVUK-i ka bërë një vlerësim të objekteve agro-ushqimore të Kosovës (për mish, qumësht, thetore, magazinim të ftohtë të qumështit) për të caktuar nevojat e përmirësimit. Procesi tani duhet të zbatohet dhe të mbështetet nga Ministria përmes skemës së grandeve të saj. Ka të ngjarë që shumë stabilimente të tilla të mbyllen sepse nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të investuar.

Institucionet që punojnë në këtë sektor duhet të forcohen me tej. Buxheti i Ministrisë është rritur kohëve të fundit megjithëse në një bazë shumë të ulët dhe është i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat. AVUK-i nuk ka staf të mjaftueshëm për të mbikëqyrur zbatimin e ligjeve dhe laboratorët e saj nuk kanë personel dhe pajisje përkatëse. Ekzekutimi i kontrolleve fito-sanitare është i mangët. Infrastruktura e inspektimit veterinar në pikat kufitare mbetet e dobët dhe bartja e mostrave nga kufijtë për në laborator nuk është e organizuar në mënyrë funksionale. Kosova ende nuk e ka përpiluar listën e sëmundjeve të bimëve në territorin e saj.

Ka mungesa të inspektorëve për siguri ushqimore dhe inspektorëve të veterinarëve: është menduar të ketë transferime nga komunat për në AVUK por ky proces nuk është kompletuar ende. Ky proces do të ndihmonte për të kontrolluar tregtinë dhe thërrjen e paligjshme të kafshëve dhe për të forcuar kontrollin e tregjeve të kafshëve. Kosova ka punuar me vite në krijimin e bazës së të dhënave për identifikimin, regjistrimin dhe lëvizjen e kafshëve. Sistemi IT është tani operativ por futja e të dhënave të kafshëve e sidomos lëvizjes se tyre nuk është sistematike. Kosova duhet të bëjë përpertime në kontrollimin dhe çrënjosjen e sëmundjeve të kafshëve. Kosova nuk ka infrastrukture të nevojshme për mbledhjen dhe përpunimin e nën-produkteve të kafshëve, edhe pse një studim i fizibilitetit për themelimin e një stabilimenti të tillë ishte përfunduar.

Kosova po përpqet të krijojë infrastrukturen statistikore për menaxhimin e politikës bujqësore por madhësia mesatarisht e vogël e fermave në Kosovë dhe një pjesë e madhe joformale e sektorit të bujqësisë e komplikojnë këtë detyrë. Regjistri i fermave dhe rrjeti i llogaritjes së të dhënave për fermat nuk janë te plotë. Vitin tjetër Kosova synon të kryejë një regjistrim të bujqësisë. Ekzistojnë dallime të mëdha mes të dhënave të BE-së dhe atyre të Kosovës mbi tregtinë bujqësore.

Në të njëjtën kohë, Kosova ka kapacitete për të vazhduar reformat në këtë fushë. Bujqësia e Kosovës përballë me pengesa serioze në konkurrencë: pronat janë kryesisht gjysmë funksionale, parcelat tokësore janë te copëtuara dhe kopetë e kafshëve te vogla. Menaxhimi i tokës vuan nga një urbanizim i pakontrolluar dhe mungesa e procedurave të duhura për vlerësim dhe ri-klasifikim të tokës. Qasja në financa është një tjetër sfidë e madhe.

Bashkëpunimi në kontekstin e MSA-së do të synojë të ndihmojë Kosovën në modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë së saj dhe sektorit agro-industrial. Në veçanti kjo do të përfshijë bashkëpunimin me prodhuesit dhe autoritetet rregullative për të ndihmuar ato në përmirësimin e kriterëve të sigurisë së ushqimit dhe standardeve të kualitetit të BE-së si dhe standardet e BE-së për shëndetin e kafshëve dhe bimëve në forme të ndihmës, trajnimit dhe organizimit të kontrollit më qëllim të harmonizimit gradual me standardet e BE-së; zhvillimi i shtuar i fermave private dhe kanaleve të shpërndarjes, metodave të ruajtjes dhe tregtimit; modernizimi i infrastrukturës rurale (transporti, telekomunikacioni, furnizimi me ujë, menaxhimi i mirë i pyjeve në balancimin e ruajtjes së pyjeve me shfrytëzimin e burimeve ekonomike, përmirësimin e produktivitetit dhe kualitetit duke përdorur metodat dhe prodhimet e duhura; trajnimin dhe mbikëqyrjen në përdorimin e metodave kundër ndotjes lidhur me të dhënat mbi; zhvillimin e metodave të qëndrueshme bujqësore (përfshirë prodhimet organike; zhvillimin dhe modernizimin e firmave për përpunim dhe metodave të tyre të marketingut, nxitjen e bashkëpunimit industrial në bujqësi dhe shkëmbimet e përvojave.

3.7.4. Doganat, tatimet dhe kontrolli financiar

3.7.4.1. Doganat

Legjislacioni doganor i Kosovës është kryesisht në përputhje me kodin doganor të BE-së. Te ardhurat që mblidhen nga shërbimi doganor, përfshirë TVSH-në, akcizën mbi mallrat e importuara dhe vendore përfaqësojnë pjesën më të madhe të hyrave buxhetore të Kosovës. (rreth 60%) dhe vazhdojnë të rriten çdo vit.

Shërbimi Doganor ka bere përpjekje te rëndësishme për modernizimin e vet. Një përpqim i vazhdueshëm është gjithashtu i dukshëm në fushën e kapaciteteve administrative dhe operative. Një numër i operacioneve janë ndërmarre kundër kontrabandës dhe kimit të organizuar. Vëmendje e veçante i është kushtuar konfiskimit të pijeve alkoolike të falsifikuara dhe kontrabandës së duhanit. Disa përpjekje janë bërë në zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, luftës kundër kontrabandës së narkotikeve dhe shpëlarjes së parave.

Kosova është aktive në bashkëpunimin ndërkombëtar doganor. Ajo ka nënshkruar nëntë marrëveshje

dypalëshe dhe marrëveshjet tjera janë në negociim e sipër. memorandumet e mirëkuptimit dypalësh në sistemin e shkëmbimit elektronik të dhënave të para mbërritjes së informacionit(SEED) janë nënshkruar edhe me Shqipërinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi. Që në fillim të shtatorit sistemi për përpunimin e deklaratave doganore (ASYCUDA) e cila lehtëson zhdoganimin pa letra, është bere operativ.

Në përgjithësi, legjislacioni është në sasi të madhe në përputhje me standardet e BE-së dhe administrata doganore ka kapacitet të mjaftueshëm.

Situata në veri paraqet një sfidë të veçantë për doganat. Në veri të Kosovës Shërbimi Doganor i Kosovës vazhdon të bashkëpunojë me EULEX-in. Pas incidenteve në Korrik të vitit 2011 dhe marrëveshjeve të mëvonshme doganore për vulat doganore dhe MIK-un në fushën e dialogut Beograd/Prishtine, një trafik shumë i kufizuar komercial qarkullon përmes dy portave në veri. Të gjitha automjetet komerciale vazhdojnë të drejtohen për në Mitrovicë/Mitrovica në terminalin për zhdoganim. Në këto porta të hyrat nuk mblidhen. Mallrat që i nënshtrohen kontrollit të akcizës, ato sanitare dhe fito-sanitare nuk janë të lejuara të kalojnë përmes këtyre dy pikave kufitare. Për shkak të mungesës efektive të mbikëqyrjes doganore në kufi/kufirin administrativ në mes të veriut të Kosovës dhe Serbisë mallrat shpesh hyjnë në Kosovë pa u zhdoganuar.

Certifikatat e prejardhjes për mallrat që eksportohen janë të vërtetuara nga dogana për mallrat që kanë prejardhje si nga veriu ashtu edhe nga pjesa tjetër e Kosovës. Aktualisht dogana e Kosovës po përballet me një sfidë në kuptimin e qasjes në territorin e veriut. Kjo ka implikime në respektimin e rregullave të prejardhjes së mallrave nga ky territor. Në praktike kërkesat për certifikata të prejardhjes së mallit janë të pakta.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, janë të nevojshme reformat dhe modernizimi i mëtejshëm i doganës së Kosovës. Për më tepër objektet e disa pikave të kalimit kufitar duhet të përmirësohen. Ekziston gjithashtu një nevojë për të ndërmarrë trajnime të mëtejshme të stafit dhe përqendrimi në ngritjen e kapaciteteve në lehtësimin e tregtisë, bashkëpunimit të doganave, vlerësimit doganor dhe zbatimi i të drejtës së pronësisë intelektuale.

Kosova duhet të sigurohet që autoritetet e saj doganore të rrisin edhe më tej efektivitetin e tyre për të përmbushur kërkesat që rrjedhin nga tregtia e liberalizuar, tregtia e preferuar nën MSA-në, në veçanti në lidhje me certifikimin e duhur të origjinës dhe metodave të hetimit dhe zbatimit. Formalitetet doganore nuk do të duhej të ishin pengesë për tregtinë.

3.7.4.2. Tatimet

Administrata Tatimore e Kosovës është autoriteti ekzekutiv për taksa, përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit lidhur me taksat. Kosova mbështetet kryesisht nga taksat indirekte të mbledhura në kufi: vetëm 14% të të gjitha të hyrave tatimore rrjedhin nga taksat e drejtpërdrejta .TVSH-ja është 16% dhe vetëm kompanitë me qarkullim vjetor mbi 50.000 € i nënshtrohen asaj. Tatimi mbi të ardhurat personale ka katër norma (0,4,8 ose 10%). Shkalla e 10% e të ardhurave vlen për të ardhurat që tejkalojnë mbi 5.400 € në vit. Ka tri norma për taksimin e korporatave (4,8 ose 10%) ku më e larta vlen për të ardhurat mbi 50.000 € /në vit. Në vitin 2011 shumica e taksave direkte arrinte në vetëm 3.2 % të PBB-se. Kjo është shumë e ulët.

Evazioni fiskal mbetet mjaft i përhapur .Për tu marrë me këtë sfidë strategjia e menaxhimit të përmbushjes së taksapaguesit (2012-2015) është përgatitur. Vonesave të mëdha në mospagesa tatimore po u kushtohet rëndësi. Njësia e Hetimeve Tatimore është krijuar brenda Administratës Tatimore dhe regjistri i taksapaguesve po përmirësohet .Numri i deklarimeve elektronike mbi tatimin është rritur ndjeshëm. Përparimi i lavdërueshëm është bere duke themeluar zyrat e përbashkëta për regjistrimin e bizneseve dhe automjeteve

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së autoriteti tatimore duhet të jenë në gjendje për të përshtatur politikën dhe të identifikojnë mjetet për përmirësimin e efektivitetit në mbledhjen e taksave. Përqendrimi duhet të jetë në zbatim. Efikasiteti i punës duhet të rritet ashtu si edhe bashkëpunimi midis

Administratës Tatimore , Policisë dhe Gjykatave. Sistemi bazë i TI-së (SIGTAS) duhet të zëvendësohet me një infrastrukturë moderne. Gjithashtu edhe struktura tatimore duhet të jetë në përputhje me BE-në.

Bordi i pavarur për ankesa dhe rishqyrtime të bizneseve dhe tatimpaguesve kundër Administratës Tatimore dhe vendimeve të shërbimit doganor duhet të ngrit efikasitetin e vet. Një prapambeturi e konsiderueshme e më tepër se 1,900 rasteve (543 në tatime dhe 1,337 në dogana) duhet të merret parasysh. Si shtesë, 119 raste janë dërguar në Gjykatën Supreme për arsye procedurale që sjell një ngarkesë të përgjithshme prej rreth 2.000 rasteve. Për të zvogëluar rastet e prapambetura kapaciteti i Bordit duhet të forcohet. Kosova gjithashtu duhet të përgatisë Legjislacionin për të përfshirë vendimet e apelit në sistemin e gjykatave të rregullta duke themeluar një sektor në gjykatën administrative.

Bashkëpunimi me BE-në sipas MSA-së do të lehtësonte reformimin e sistemeve fiskale në Kosovë dhe do të nxiste zhvillimin e mëtejshëm të administratës tatimore për të siguruar mbledhjen efektive të taksave dhe luftën kundër evazionit fiskal. Bashkëpunimi do të kishte si qëllim shmangien e konkurrencës së dëmshme tatimore.

3.7.4.3. Kontrolli Financiar

Dispozitat kryesore rregullatorë dhe Institucionet e Kontrollit të Brendshëm Financiar dhe publik janë të vendosura mire. Ligji për auditimin e brendshëm ofron një bazë të mirë ligjore për formimin e Njësisë për Auditim të Brendshëm në Kosovë. Ato janë themeluar në shumicën e organizatave buxhetore duke përfshirë komunat. Korniza ligjore për auditim të jashtëm është e vendosur. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm(ZAP)është një institucion i pavarur kushtetues që i raporton Kuvendit të Kosovës. Rregullat e brendshme që rregullojnë punën e raportimit të ZAP-it(shih doracaket e auditimit,udhëzimet,dhe menaxhimin e cilësisë së auditimit)janë të vendosura mire. ZAP-i kryen kryesisht auditime rregullatore. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike të Kuvendit rregullisht diskuton mbi raportet e auditimit të përgatitura nga ZAP-i.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, Kosova duhet të përmirësojë praktiken e përditshme të kontrollit të brendshëm. Më shumë duhet të bëhet për të zhvilluar një mjedis të bazuar në kontrollin e rrezikut, për të përmirësuar efikasitetin, efektivitetin dhe ekonominë e operacioneve, të rritet besueshmëria (financiare) e raportimit dhe të bëhen planifikime më të mira dhe marrëveshje buxhetore. Ekziston edhe një nevojë për një mirëkuptim më të madh dhe pranim të përgjegjësive brenda organizatave buxhetore në mënyrë që të krijohet një kulturë e delegimit të përgjegjësive dhe autoritetit. Kosova duhet ti kushtojë vëmendje të veçantë pavarësisë së funksionimit të brendshëm auditues, veçanërisht në nivelin lokal.

Në lidhje me ZAP-in ajo duhet ti përmirësoje kapacitet e saj në ofrimin e përmbushjes së punës audituese. Për me tepër, pasi që ZAP-i është pjese e shërbimit civil, zbatimi i legjislativit mbi ligjin e shërbimit civil është tepër i këshilluar dhe kufizon në praktike pavarësinë e veprimt të ZAP-it.

Bashkëpunimi me BE-në sipas MSA-së duhet të përqendrohet në kontrollin e brendshëm financiar dhe publik dhe auditimin e jashtëm. Caku i bashkëpunimit do të jetë ngritja dhe zbatimi i kontrollit dhe auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe forcimi i rolit të auditimit të jashtëm në përputhje me kornizat dhe standardet ndërkombëtare.

3.7.5. Punësimi, politika sociale, politika e shëndetit publik, arsimimi dhe trajnimi, hulumtimi i teknologjisë dhe zhvillimi

3.7.5.1. Punësimi, politika sociale dhe politika e shëndetit publik

Gjate tri viteve të fundit Kosova ka vënë në vend elementet e kornizës ligjore të nevojshme për këtë fushë dhe ofron një ndihmë themelore sociale. Ka një kornizë ligjore për të drejtat dhe detyrimet e personave të

papunë dhe punëkërkuessit, si dhe mbështetjen e personave që kanë vështirësi të hyjnë në tregun e punës. Legjislacioni i Kosovës gjithashtu rregullon regjistrimin e personave të papunë dhe të punëkërkuessve, dhe rregullon masat mbështetëse. Ligji i punës i miratuar në vitin 2011 i sjell standardet e Kosovës më afër atyre të Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Ligji i ri mbi skemën e ndihmës sociale përfshin masa për personat e papunë për të lëvizur nga varshmëria nga ndihma sociale drejt tregut të punës.

Kosova ka një strategji kombëtare të punësimit dhe strategji sektoriale. Zbatimi është duke u zhvilluar Shërbimet Publike të Punësimit (PES) dhe shtatë zyrtare rajonale të koordinuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Inspektorati i punës mbikëqyr zbatimin e dispozitave ligjore të punës. Kosova ka bërë digjitalizimin e sistemeve të regjistrimit mbi papunësinë dhe ndihmat sociale.

Kosova ka tre programe kryesore të asistencës sociale: sistemet e transferimit të parave për familje, përfitimet e veteranëve të luftës dhe pensionet invalidore për njerëzit në moshë pune të cilët kanë aftësi të kufizuara dhe janë të paafte për punë. Skema e ndihmës sociale përpunohet për të mbushur hendekun e krijuar nga mungesa e llojeve të tjera të përfitimeve si: përfitimet për fëmijë, përfitimet në rast sëmundjeje dhe përfitimet nga papunësia. Komunitetet janë gjithnjë e më përgjegjëse për familjet dhe shërbimet sociale që mundësohen nga qendrat e mirëqenies sociale. Sistemi qendror i pensioneve ofron një asistencë të nivelit minimal për personat në pension. Punëtorët nën 55 vjeç janë të mandatuar që të vendosin 10% të pagave të tyre në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Këshilli ekonomik dhe social është operacional por dialogu në mes të qeverisë, dhe organizatave të punonjësve dhe punëdhënësve është i ulët. Kosova ka dy organizata të punës-dhënësve, një sindikatë të llojit konfederativ dhe 18 sindikata zëjtare. Nuk ka të dhëna mbi anëtarësimin në sindikatat e zëjtareve.

Infrastruktura e shërbimeve shëndetësore të Kosovës përbëhet nga një kombinim i financuar nga qendra dhe një sistem tre-shtresor i financuar në mënyrë private. Korniza legjislative në sektorin shëndetësor është përmirësuar. Një reformë madhore shëndetësore është duke u zhvilluar.

Për të përmbytur obligimet e veta sipas MSA-së, Kosova duhet të bëjë më shumë në nxitjen e dialogut social. Legjislacioni i rëndësishëm për duhanin, gjakun, indet, qelizat, dhurimin e organeve, transplantimin dhe sëmundjet ngjitëse ende duhet të miratohet apo ndryshohet. Kosova gjithashtu duhet të miratojë ligjet mbi sigurimin shëndetësor dhe shëndetin publik. Qasja e lehtë dhe e përbalueshme për të gjitha shtresat shoqërore mbetet një brengë. Shërbimet e mira shëndetësore dhe menaxhimi i burimeve njerëzore, përgjegjësia dhe parimet e angazhimit duhet të vihen në vend. Statistikat mbi të dhënat shëndetësore dhe informimi mbetet i dobët. Ka mungesë të burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore. Miratimi, zbatimi dhe fuqizimi i legjislacionit shëndetësor të BE-së mbetet i dobët. Në përgjithësi, kompletimi dhe zbatimi i politikave dhe legjislacionit ka të ngjarë të mbetet sfida për vitet në vijim, sidomos kur është fjala për reformat ekonomiko sociale dhe zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm shëndetësor.

Bashkëpunimi në këtë fushë sipas MSA-së do të synojë mbështetjen e Kosovës në reformimin e politikave të punësimit. Ajo gjithashtu do të nxisë dialogun social si një forcë kyçe në shtytjen e reformës ekonomike dhe sociale si dhe përafrimin ligjor mbi ligjin e Punës dhe shëndetit e sigurisë në punë. Sipas MSA-së, synim do të jetë bashkëpunimi për përshtatjen e sistemit të Kosovës për sigurim social ndaj situatës së zhvillimit ekonomik dhe kërkesave të reja sociale. Kosova gjithashtu do të inkurajohet që të miratojë politikat për përfshirjen e plotë sociale si dhe ato kundër diskriminimit bashkë me masat për përmirësimin e gjendjes së grupeve më të rrezikuara sociale.

Sa i përket sektorit të shëndetësisë MSA-ja do të ndihmojë Kosovën drejt një sistemi shëndetësor më cilësor dhe të qëndrueshëm, të arritshëm për të gjithë duke u bazuar në standardet e BE-së. Sipas MSA-së Kosova do të duhet që: i) të zhvillojë më tej politikat e mbrojtjes shëndetësore në përputhshmëri me ligjet e BE-së për përmirësimin e shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve të popullsisë së saj; ii) të harmonizojë legjislacionin e saj për mbrojtjen e shëndetit, të zhvillojë struktura të pavarura dhe efektive të administratës dhe zbatimit të fuqive për sigurimin e shëndetit parësor dhe nevojave të sigurisë në mbrojtjen e të drejtave të pacientëve; dhe iii) të mbrojë qytetarët nga kërcënimet e shëndetit dhe sëmundjeve, të promovojë jetën e shëndetshme dhe të bashkëpunojë me BE-në në çështjet e shëndetit.

3.7.5.2. Arsimimi, trajnimi, hulumtimet dhe inovacioni

Kosova ka një strategji gjithëpërfshirëse afatmesme të arsimit, që përfshin të gjitha nivelet. Legjislacioni për arsimin e lartë është i vendosur dhe kërkon nga Institucionet e arsimit të lartë (dhe programet) që ti nënshtrohen një vlerësimi të jashtëm nga ana e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (AAK). Një numër programesh nuk i plotësojnë standardet e cilësisë së AAK-së. Në bazë të ligjit për arsimin parauniversitar Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) i ka dhënë përparësi zhvillimit profesional të mësim dhënësve dhe modernizimit të trajnimeve për mësimdhënës në përputhje me kornizën e re të kurrikulimit të Kosovës. MASHT-i dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë vënë theksin në arsimin dhe trajnimin profesional (VET) si mënyrë për nxitjen e zhvillimit të aftësive, zhvillimit të punësimit dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Procedurat e vlerësimit dhe akreditimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) janë të vendosura mirë. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) kryen detyrat e veta në mënyrë efektive, por me burime të kufizuara. Kosova merr pjesë në Platformën e Ballkanit Perëndimor të Arsimit. Kërkesa e Kosovës për anëtarësim në Nismën e Reformave të Arsimit në Evropën juglindore është duke u përpunuar nga sekretariati.

Kosova ka ligjin për hulumtime shkencore dhe synon rritjen e pjesëmarrjes në projektet ndërkombëtare për hulumtim. Kosova ka tri universitete publike dhe katërmëdhjetë institute publike për hulumtim. Kosova ka bërë përparime në përcaktimin e themelit institucional dhe orientimit strategjik në forcimin e kapaciteteve të saj për hulumtim dhe zbulim. Këshilli i Kosovës për hulumtim është themeluar dhe ka zhvilluar një program pesë vjeçar për të përmirësuar sektorin e hulumtimit dhe lidhjen e tij me edukimin e lartë. Integrimi në Zonën Evropiane të hulumtimeve dhe kontributi për shoqatën e zbulimeve ishte vendosur si synim afatmesëm për Kosovën. Kosova ka marr pjesë në kornizën e shtatë të hulumtimit dhe teknologjisë në BE.(FP7,2007-2013)si partnere në projekt.

Në përgjithësi,fushat e arsimit,trajnitimit,hulumtimeve dhe zbulimeve,kornizat ligjore dhe të politikave janë të vendosura mire,siç janë edhe institucionet përkatëse.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, Kosova ka nevojë të rrisë investimin e saj në arsim dhe hulumtim. Kjo është me rëndësi në dritën e zhvillimit të nevojave ekonomike dhe sociale. Sistemi i arsimor do të duhet gjithashtu të merret gradualisht me nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara. Përpjekje të mëtejshme duhet të bëhen në sigurimin e kushteve përkatëse për arsimimin e personave që i takojnë pakicave duke përfshirë qasjen në arsim në gjuhën e tyre.

Ekziston nevoja për të krijuar një fond për hulumtim në mbështetje të aktivitetit të hulumtuesve si dhe të bëhet ngritja e kapaciteteve për hulumtim në Kosovë. Sfidat kryesore janë,mungesa e personelit të kualifikuar shkencor,numri i vogël i studentëve të doktoraturës, pajisjet e pamjaftueshme laboratorike dhe teknikat joadekuate të dish- si të veprsh. Komuniteti hulumtues në Kosovë mbetet mjaft i izoluar viza-vi komunitetit shkencor ndërkombëtar. Kosova duhet të bëjë ngritjen e kapaciteteve në një numër të sektorëve kyç (efikasitet energjetik, ambient, sigurinë ushqimore, hulumtimet shëndetësore dhe hulumtimin e shkencave sociale) të cilat janë identifikuar si përparësi.

Bashkëpunimi sipas MSA-së do të ngrëjë me tutje programet dhe mekanizmat ekzistues dhe do të vazhdojë të ndihmojë Kosovën në ngritjen nivelit të arsimit të përgjithshëm, arsimit të lartë, trajnitimit profesional dhe nxitjen e bashkëpunimit të rinjve. Gjithashtu mund të inkurajojë zhvillimin e një ambienti të përshtatshëm për hulumtim sidomos përmes hulumtimeve të përbashkëta dhe sipërmarrjeve për zbulime dhe bartje të teknologjisë të -dish se -si.

3.7.6. Shërbimet kulturore, audio vizuale, të telekomunikacionit, postare dhe shoqëria informative

Korniza legjislative për sektorin e telekomunikacionit është e përfshirë nga ligjet kornizë (ligji mbi telekomunikacionin, ligji mbi shërbimet e shoqërisë informative, ligji mbi parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë, ligji mbi shërbimet postare). Këto ligje kane rritur përshtatjen me *acquis* duke përfshirë çështjet si analizat e tregut, përcaktimin e furnitorëve të fuqishëm të tregut, shthurjen e plotë të përbashkët të ciklit lokal dhe nën-ciklit, masat për qasje dhe komunikim të ndërsjellë. Në vitin 2012, Kosova miratoi një ligj për financimin e transmetuesit të shërbimeve publike (RTK) dhe ligjin mbi Komisionin e Pavarur për Media (KPM). Ligji mbi RTK-në gjithashtu parasheh krijimin e një kanali televiziv në gjuhën serbe.

Gjatë tri viteve të fundit, Telekomunikacioni i Kosovës, shërbimet postare dhe sektori i shoqërisë informative kanë krijuar organet e nevojshme administrative dhe rregullatore për fillimin e zbatimit të *Acquis-it* në këtë fushë. Telekomunikacionet janë të rregulluara nga agjencia rregullative e telekomunikacionit (ART) dhe sektori audio vizual është i menaxhuar nga KPM-ja e cila synon ta menaxhojë këtë sektor në përputhje me standardet e BE-së.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet për të kompletuar kornizën ligjore për zbatimin e standardeve të BE-së në këtë fushë. Kosova duhet të miratojë ligje mbi organet qeveritare të shoqërisë informative dhe për komunikimet elektronike. Institucionet që punojnë në këtë sektor duhet të forcohen: pavarësia dhe kapaciteti i që të dyjave ART-së dhe KPM-së është sfiduar nga ndërhyrjet e qeverise, paga e ultë dhe mungesa e burimeve dhe buxheteve. Procesi i emërimit të këshillit të ri të KPM-së filloi vetëm në Qershor të vitit 2012 pasi që KPM-ja ishte pa një bord që nga Dhjetori i vitit 2010.

Qëndrueshmëria afatgjate e RTK-së është ende e pazgjidhur, pavarësisht ligjit të fundit mbi RTK-në. Buxheti për financimin e institucioneve kulturore të Kosovës është i kufizuar. Kapaciteti i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për zhvillimin edhe koordinimin e politikave për shoqërinë informative, duke përfshirë çështjet e përfshira nga Agjenda Digjitale e Evropës është i dobët. Forcimi i kapacitetit administrativ dhe intensifikimi i bashkëpunimit ndërkombëtar për kulture dhe media është me rëndësi për përgatitjen e Kosovës për pjesëmarrje në programet e Evropës në këtë fushë.

Mungesa e kapaciteteve të zbatimit si edhe problemet me statusin e pengojnë aftësinë e Kosovës për zbatimin e plotë të *Acquis-it*. Kosova nuk e ka kodin e vet shtetëror dhe përdor kodet e shtetit të Serbisë për telefoninë fikse, dhe çdo operator i telefonisë mobile përdor kodet e shteteve të tjera (Monako dhe Slloveni). Kjo gjë krijon shpenzime shtesë, zvogëlon kontrollin e Kosovës mbi sistemet e saj, krijon probleme të bashkërenditjes me rregullatorët e Monakos dhe Sllovenisë dhe përbën një pengesë në zbatimin e rregullave të BE-së për bartjen e numrave. Përveç kësaj, Kosova nuk ka emër për domenin e saj të internetit, dhe kompanitë e jo licencuara të telefonisë mobile (Serbe) vazhdojnë të operojnë në Kosovë. Kjo ndërhyrje në spektrin menaxhues të Kosovës. Kosova nuk është anëtare e UNT-së dhe prandaj ka një shpërndarje të mjaftueshme të spektrit, përfshirë edhe transmetimet digjitale.

Bashkëpunimi për telekomunikacionin dhe shërbimet postare sipas MSA-së do të nxisë rreshtimin gradual me acquis. Kjo do të përfshijë në veçanti i (zhvillimin e mëtejshëm të aspekteve ligjore dhe rregullative për telekomunikacionin dhe shërbimet postare, ii (liberalizimin e shpejte të sektorit, iii (nxitjen e një mjedisi miqësor për investuesit në modernizimin e rrjetit të telekomunikacionit të Kosovës dhe integrimin e tyre në rrjetet Evropiane dhe botërore, iv (reformat institucionale të përshtatshme për një mjedis të liberalizuar.

MSA-ja do të nxisë bashkëpunimin kulturor me synim që të forcojë kapacitetet e politikave kulturore të Kosovës, duke përforcuar kapacitetin e veprimeve kulturore si dhe rritjen e mirëkuptimit të ndërsjellë në mes të individëve, pakicave dhe njerëzve .Kosovës do t'i duhet që gradualisht të vë në linjë politikat dhe legjislacionin me ato të BE-së, duke përfshirë edhe transmetimet ndër kufitare/kufirit administrativ dhe blerjen e të drejtave të pronësisë intelektuale për programet dhe transmetimet përmes satelitit apo

kabllovikut. Reformat e saj institucionale do të duhej të promovojnë diversitetin kulturor, lirinë e shprehjes, lirinë e fjalës dhe lulëzimin e shërbimeve të transmetuesit publik, te përshtatshëm për një mjedis të liberalizuar, si dhe ruajtjes së pavarësisë dhe kapaciteteve të organeve rregullative. MSA-ja do të përfshijë gjithashtu edhe dispozitat e themelimit të parimeve të përgjithshme për pjesëmarrjen e Kosovës në Programet e BE-së siç është Programi Evropian i Kreativitetit.

3.7.7. Transporti

Kosova ka miratuar një numër të pjesëve të legjislacionit sektorial, edhe pse disa prej tyre do të duhet të kompletohen. Korniza ligjore e transportit rrugor është themeluar në bazë të *acquis*. Ligji i vitit 2010 për hekurudhat vendos kornizën për degëzimin e sektorit, e cila është pothuajse e kompletuar. Kosova ka bërë përparim në miratimin e Standardeve të BE-së për aviacionin përmes të një përfshirjeje aktive në Marrëveshjen e Përbashkët Evropiane të Aviacionit, veçanërisht sa i përket rregullativave ekonomike.

Gjatë tre viteve të fundit, Kosova ka themeluar institucionet e nevojshme për zbatimin e *Acquis-it* në këtë fushë. Transporti është përgjegjësi e Ministrisë së Infrastrukturës, me sektorë që menaxhohen nga autoritetet përkatëse rregullative, siç janë Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës (AACK) ose Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH). Një organ hetimi për aksidente dhe incidente që përfshin transportin ajror dhe hekurudhor është duke u themeluar aktualisht.

Në Kosovë nuk ka transport të kombinuar. Në mungesë të ndonjë anije detare, rrugëve ujore në brendësi të vendit ose anijeve ujore në brendësi të vendit, nuk mund të zbatohet *acquis* për Kosovë as për transportin detar e as për rrugët ujore.

Për të përmbushur obligimet e saj sipas MSA-së, Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet për kompletimin e kornizës ligjore për zbatimin e standardeve të BE-së për transport. Kosova duhet të ri-hartoj tre ligje të transportit rrugor në mënyrë që ti harmonizojë ato me *acquis*, veçanërisht në fushat e qasjes në punë, bartjes, transportit të udhëtareve dhe transportimit të mallrave të rrezikshme. Ligji mbi agjencinë e navigacionit ajror, që do të garantojë menaxhimin profesional dhe pavarësinë e Ofruesve të Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ANSP) duhet të miratohet gjithashtu.

Institucionet që punojnë në këtë sektor duhet të fuqizohen: rregullatori i hekurudhave ka mungesë të stafit, kapaciteteve dhe buxhetit. ANSP-ja është ndarë nga Autoriteti Kombëtar Mbikëqyrës (NSA) por ende duhet të certifikohet. Siguria e aviacionit që menaxhohet nga Ministria e Punëve të Brendshme, është brengosëse: për shkak të mungesës së buxhetit dhe trajnimeve inspektoret humbën akreditimin e tyre në vitin 2010.

Zbatimi i *Acquis-it* për transportin rrugor është i kufizuar. Siguria rrugore është një brengë dhe shkalla e aksidenteve dhe vdekshmërisë në rrugët e Kosovës është shumë e lartë. Kapacitetet e kufizuara të inspektimit, automjetet e vjetra, dhe cilësia e ulët e infrastrukturës rrugore jashtë rrugëve kryesore pengon zbatimin e legjislacionit. Nivelet e trafikut hekurudhor janë të ultë, lokomotivat e vjetruara dhe është vështirë për ti mbuluar nevojat financiare të menaxherit të infrastrukturës me aftësitë e ofruesit të shërbimeve për ti paguar ato.

Infrastruktura e transportit të Kosovës edhe më tej duhet të zhvillohet për të nxitur zhvillimin ekonomik. Strategjia aktuale e transportit me një theks të madh në ndërtimin e rrugëve të reja vetëm shton mosbalancimin e sektorit të transportit, duke shtyrë investimet në format tjera të transportit, në veçanti në hekurudha. Është me rëndësi të sigurohen fonde për mirëmbajtjen e duhur të rrugëve.

Ashtu si mungesa e kapaciteteve zbatuese, problemet e statusit kanë ndikim në aftësinë e Kosovës për të zbatuar në tërësi *acquis*. Kosova (duke përfshirë operatorët e saj të transportimit) nuk mund të anëtarësohen në shumë prej organeve ndërkombëtare ose Evropiane që rregullojnë transportin ose shoqatat e sektorëve përkatës. Kosova është duke u penguar që të arrije disa zgjidhje me bazë teknike në fusha të caktuara. Kjo është veçanërisht me rëndësi për aviacionin: AACK-u nuk është pjesë e sistemit të standardizuar të inspektimit dhe vlerësimit të sigurisë për avionët e huaj dhe nuk ka qenë në gjendje të hyjë

në marrëveshje pune me EASA. Sidomos, sektori i aviacionit të Kosovës vazhdon të vuajë nga kufizimet e Serbisë për fluturime të drejtpërdrejta për/nga Prishtina mbi territorin e Serbisë që ka ndikim financiar për operatorët ajror dhe një ndikim për ambientin e rajonit

Në transport, bashkëpunimi sipas MSA-së do të kontribuojë në ristrukturimin dhe modernizimin e sistemeve Kosovare të transportit dhe përmirësimin e infrastrukturës përkatëse, duke përmirësuar lëvizjen e lire të qytetareve dhe të mallrave, dhe duke arritur standarde të krahasueshme me ato që mbizotërojnë në BE, duke e përshtatur legjislacionin e transportit me BE-në, dhe duke lejuar qasje të avancuara dhe reciproke në tregjet e pajisjeve dhe transportit të BE-së dhe Kosovës.

3.7.8 Energjia ,përfshirë sigurinë bërthamore

Si palë kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë Kosova tashmë ka miratuar një numër të ligjeve kyçe që lidhen me sektorin e energjisë në përputhje me *Acquis-in*. Sektori i saj i energjisë udhëhiqet nga një pako prej tre ligjeve të miratuara në vitin 2010, të cilat synojnë zbatimin e pakos së dytë të tregut të energjisë së brendshme të BE-së. Ligji i 2011 për efikasitetin e energjisë është një bazë për zbatimin e shumë parimeve të efikasitetit të energjisë të *Acquis-it*. Kosova ka miratuar një kornizë ligjore për zbatimin e *Acquis-it* të BE-së për sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga radioaktiviteti dhe krijimin e një agjencie për siguri bërthamore.

Gjatë tre viteve të fundit ,Kosova ka themeluar institucionet e nevojshme për zbatimin e *Acquis-it* në këtë fushë. Ashtu si Ministritë përgjegjëse në këtë fushë (Ministria për Zhvillim të Energjisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për çështjet bërthamore) Kosova ka një rregullator (Zyra e Rregullatorit të Energjisë), dhe tash së voni ka themeluar Agjencinë për Siguri Bërthamore. Operatori i Sistemit të transmisionit të Kosovës OSTK është themeluar dhe është duke e kryer punën e saj siç duhet. OSTK-ja gjithashtu po bën përmirësimin e rrjetit të transmisionit dhe në këtë mënyrë po zvogëlon humbjet në transmision.

Për të përmbushur obligimet e veta sipas MSA-së, Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet për të kompletuar kornizën ligjore për zbatimin e energjisë bërthamore dhe standardet e sigurisë të BE-së. Kosova duhet të fillojë përgatitjen për zbatimin e pakos së tretë të energjisë së tregut të brendshëm, një obligim ligjor që nga viti 2015 sipas Marrëveshjes së Komunitetit të Energjisë. Kosova gjithashtu duhet të bëjë përpërim në zbatimin e rregullave të BE-së për rezervat e detyrueshme të naftës dhe duhet të ndryshoj kornizën ligjore të saj për sigurinë bërthamore për tu përgatitur për zbatimin e mëtejshme të *Acquis-it* për siguri bërthamore. Institucionet që punojnë në këtë sektor duhet të forcohen: agjencia për siguri bërthamore ka mungesë të stafit, Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka nevojë për burime të mjaftueshme për të kryer përgjegjësitë e saj, ku Kosova duhet të fus në veprim Agjencinë për Efikasitet Energjetik dhe të krijoj fond për efikasitetin energjetik. Ristrukturimi i sektorit ,përfshirë tenderimin për kapacitetet e gjeneratës së re dhe kompanisë se shpërndarjes dhe furnizimit në bazë të Rregullave të Komunitetit Energjetik duhet të vazhdojë.

Burimi i vetëm i vendor i Kosovës është linjiti:97% e energjisë së tij gjenerohet në dy impiante për djegien linjitet. Që të dyja këto janë të vjetruara,jo të besueshme dhe shume ndotëse. Kosova nuk ka energji bërthamore, burimet e saj të ripërtërishme janë të kufizuara dhe Kosova nuk është e lidhur me rrjetin e Gazit .Kosova ka nisur një tender për ndërtimin e një impianti të ri me linjit të fuqizuar që do të kishte një ndikim të thellë në përmirësimin e ndikimit në sektorin mjedisor. Kjo është gjithashtu e rëndësishme pasi që Kosova ka marrë detyrime nën Marrëveshjen e Komunitetit të Energjisë për mbylljen e Kosovës A deri me vitin 2017.

Menaxhimi i Kosovës në sistemin e saj energjetik pengohet nga ndërmarrja energjetike serbe qe mban një dege të palicencuar ne veri te Kosovës. Ekziston edhe një devijim i pushtetit hidrocentral për furnizimin në veri. Si shtesë OSTK-ja ende nuk ka marre pjese ne mekanizmat rajonale për planifikimin dhe rillogaritjen e bartjes se energjisë për shkak te dallimeve mbi statusin e saj. Si pasojë e situatës se tanishme Kosova humb te ardhura dhe mungesa e kontrollit rrezikon stabilitetin e sistemit energjetik te Kosovës.

Sipas kornizës së MSA-së, Kosova duhet të zhvillojë me tej politikat e saja të energjisë me një qëllim të integritimit gradual në politikat dhe rregullat e BE-së. Duhet të zbatohet legjislacionin aktual për tregun energjetik dhe të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme mbledhjen e faturave dhe pagesave nga numrat e tanishëm: vetëm 71% e energjisë paguhet duke nxitur një paqëndrueshmëri në rritjen e kërkesës. Kosova gjithashtu duhet të miratojë legjislacionin dytësor për të përmbushur cakun e saj prej 9% për përmirësimin të efektivitetit gjër më 2018. Korniza rregullatore për zhvillimin e energjisë ripërtërishme gjithashtu duhet të përmirësohet nëse Kosova dëshiron të përmbushë cakun e saj të planifikuar për prodhimin e 26% të energjisë së saj nga burimet e ripërtërishme gjër më 2020 (nga niveli i tanishëm prej më pak se 3%)

Bashkëpunimi sipas MSA-së në mes të Kosovës dhe BE-se në fushën e energjisë duhet të ketë parasysh parimet e ekonomisë së tregut dhe të Marrëveshjes së Komunitetit për Energji. Bashkëpunimi në veçanti do të përqendrohet formulimin dhe planifikimin e politikave të energjisë, përmirësimin e ndërlidhjes dhe modernizimin e infrastrukturës, themelimin e një tregu konkurrues për energjetike, përmirësimi dhe diversifikimin e furnizimit, menaxhimit më të mirë të shërbimeve energjetik, forcimin e rolit të rregullatorit përmirësimi i menaxhimit të kërkesës, zhvillimin e burimeve energjetike dhe energjisë së ripërtërishme, dhe nxitjen e kursimit dhe efikasitetit energjetik, nxitjen e sigurisë bërthamore dhe menaxhimin e mbeturinave bërthamore.

3.7.9. Mjedisi dhe ndryshimet klimatike

Një numër i kornizave ligjore që përfshijnë *Acquis-in* kryesor për fushat mjedisore janë të vendosura. Kosova ka miratuar ligje për vlerësimin e ndikimeve në mjedis dhe vlerësime strategjike të mjedisit gjërësisht në përputhje me standardet e BE-së. Korniza ligjore për zbatimin e standardeve të BE-së për cilësinë e ajrit është e vendosur. Kosova ka miratuar një kornizë ligjore për ruajtjen e natyrës në mënyrë që të përputhet me *acquis* e BE-së për ruajtjen e natyrës. Kornizat tjera ligjore janë në proces të miratimit. Kosova po fillon të zbatohet *acquis* e BE-së për klimën.

Institucionet kyçe janë të themeluara. Administrata përgjegjëse për politikat e mjedisit dhe klimës është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e mbështetur nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës e cila mbikëqyr gjendjen e mjedisit. Gjithashtu ekziston edhe një rrjet i inspektorëve.

Sipas obligimeve të MSA-se, Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet për kompletimin e kornizës ligjore në pajtim me standardet e BE-se për mjedis dhe klimë. Pjesa e mbetur e ligjeve kornize (për mbeturinat, kimikatet, ujin, zhurmën dhe mbrojtjen civile) duhet të miratohet dhe kompletohet nga legjislacioni dytësor.

Institucionet për zbatimin e standardeve të BE-së janë të vendosura; kapaciteti i tyre në zbatimin dhe fuqizimin legjislacionit në nivelin qendror dhe lokal duhet të ngrihen. Buxheti i përcaktuar për sektorin është i pamjaftueshëm dhe brengat mjedisore dhe klimatike nuk janë të përfshira në politikat tjera. Kosova ka mungesë të kapaciteteve njerëzore, administrative dhe të kapitalit për të zbatuar standardet e BE-së për mjedis dhe klimë.

Përgatitjet janë në një fazë të re në fushën e kontrollit të ndotjes industriale dhe menaxhimit të rrezikut. Mjedisi në Kosovë përballë me disa sfida të renda: shumica e niveleve të ndotjes janë shumë më të larta se ato të BE-së. Impiantet energjetike të linjtit janë burimi kryesor i ndotësve të ajrit, me disa (pluhur, NO_x dhe SO₂) nivele që i tejkalojnë disa here kufijtë e niveleve të BE-së dhe OBSH-së. Për më tepër, rrjeti mbikëqyrës për cilësinë e ajrit në Kosovë nuk është ende plotësisht funksional. Kosova ka vetëm një impiant për trajtimin e mbeturinave dhe ujit dhe një pjesë madhe e popullatës ende nuk është e lidhur me rrjetet për furnizim të ujit të pijshëm. Si rezultati çështjeve që kanë të bëjnë me statusin Kosova nuk është në pozite që të bëhet pjesë e shumicës së konventave, protokolleve ose marrëveshjeve tjera ndërkombëtare për mjedis. Kosova nuk është pjesë e kornizës së KB-së për konventën e ndryshimeve klimatike. Nuk ka

ndonjë strategji për ndryshimet klimatike ,plan veprimi, qëllime, masa dhe politika të gjera ekonomike për zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Sipas MSA-së, pritet që Kosova të caktojë burime thellësisht më të mëdha për implementimin e standardeve mjedisore të BE-së dhe të merret me sfidat mjedisore duke i investuar në nevoja si menaxhimin e mbeturinave ashtu edhe me cilësinë e ujit. Për te përmirësuar cilësinë e ajrit Kosova duhet të mbyllë impiantin energjetik të Kosovës A në përputhje me detyrimet e marra mbi Marrëveshjen e Komunitetit Energjetik. Konsideratat për mjedisin duhet të rrjedhin edhe në politikat tjera veçanërisht ato te energjetikës,transportit,pylltarisë ,bujqësisë dhe industrisë. Urbanizimi duhet të baraspeshohet më mire. Kosova duhet te themelojë një strategji klimatike dhe një sistem të mbikëqyrjes së gazrave serë dhe të raportoj edhe inventarin e gazrave serë.

Sipas MSA-së, Kosova duhet të forcoj bashkëpunimin e saj me BE-në ne luftën kundër përkeqësimit të mjedisit me theks në kualitetin e ajrit dhe ujit ,menaxhimin të mbeturinave dhe mbrojtjes së natyrës,mbikëqyrjen dhe zvogëlimin e shkarkimeve industriale,promovimin e energjisë efektive dhe sigurisë në të gjitha stabilimentet industriale ,mbrojtjen e tokës,klasifikimin dhe trajtimin e sigurt të kimikateve dhe planifikimin urban.

Bashkëpunimi sipas MSA-së do të përdoret gjithashtu për të zhvilluar politikën e Kosovës për klimën dhe për të ndihmuar përfshirjen e Kosovës në përpjekjet globale për të zbutur dhe adaptuar me ndryshimin e klimës. Një bashkëpunim me i ngushtë do të ndihmonte Kosovën në miratimin e legjislacionit të nevojshëm si dhe krijimin e një organizimi të duhur administrativ. Kjo do të ndihmojë Kosovën ëe përfshirjen e rrjedhave në energjetikë,transport,industri,bujqësi dhe politika te arsimit.

3.8 Bashkëpunimi Financiar

BE-ja e ka mbështetur Kosovën përmes disa instrumenteve të ndryshëm të financimit: Asistenca Komunitare për Rindërtim ,Zhvillim dhe Stabilizim(CARDS) Instrumenti për stabilitet (IfS) dhe Instrumenti i ndihmës së para-pranimit(IPA).Prej vitit 1999 deri me 2011 EU ka dhënë mbi 2.3€ miliard ndihmë financiare dhe afërsisht 1 miliard €në mbështetje të pranisë ndërkombëtare ne Kosove.

Në Kornizën Financiare të viteve 2007-2013 BE-ja ka vene në dispozicion më shumë se 630 milion €për Kosovën nen IPA-ne. BE-ja ka ofruar mbështetje në forcimin e sundimit të ligjit ,reformës administrative publike,pakicave,kulturës dhe rinisë ,zhvillimit me te gjere socio-ekonomik përfshirë tregtinë dhe zhvillimin rajonal,arsim dhe punësim dhe bujqësi. Në vitin 2011 një shume totale prej 68.7 milion €janë ndare ne baze të projektit vjetor te IPA-s(komponentë e IPA-s) në koordinim të ngushtë me Ministrinë e Integritimit Evropian dhe institucioneve tjera qeveritare. ndihma e tanishme e IPA-s është e përqendruar në sundimin ligjit, ekonomi, tregti dhe industri dhe reformën e administrues publike. Komponenti ndërkufitar i IPA-s (komponenti i II-të) u aktivizua për Kosovën në vitin 2010.

Për te ngritur përfshirjen e shoqërisë civile në dialogun e Kosovës dhe zhvillimin e politikave në vitet 2001-2013 3.3 milion €i janë vënë në dispozicion Shoqërisë Civile lehtësimin e punës së saj. Programi synon të rris dialogun në mes të institucioneve qeveritare dhe shoqërisë civile në Kosove, të rris përfshirjen e partnereve social në zhvillimet socio ekonomike dhe të siguroj kapacitete e organizatave rinore. Instrumenti Evropian për demokratizim dhe të drejtat njeriut ka dhëne ndihme shtesë për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë që nga viti 2007. Me pamjen për perspektivat e ardhshme, Komisioni ka adaptuar një propozim për Instrumentin e Ndhmës së Para-pranimit II që përfshin periudhën prej viteve 2014-2020.

Institucionet relevante dhe mekanizmat koordinues për themelimin e një bashkëpunimi në fushën e bashkëpunimit financiar janë të vendosura. Gjithashtu kemi një ngritje të nivelit të ekspertizës në përcaktim nevojave për ndihme.

Ministria e Integrimit Evropian është përgjegjëse për koordinimin e donatorëve në nivelin qendror. Përveç mbështetje së madhe nga BE-ja ka gjithashtu edhe burime tjera të ndihmës për Kosovën siç është ndihma nga vendet anëtare dhe organizatat ndërkombëtare financiare. Për të përmbushur detyrimet e veta sipas MSA-së Kosova do të ketë nevojë të sigurohet se bashkëpunimi do të vazhdojë në mbështetjen demokratike për reformat ekonomike dhe institucionale në përputhje me procesin e Procesin e Stabilizim Asociimit. Kosova duhet të sigurojë edhe koordinimin e donatoreve.

Një MSA për Kosovën do të parashihte vazhdimin e mbështetjes financiare për Kosovën për ta ndihmuar në arritjen e synimeve të marrëveshjes. Ndihma e tillë mund të përqendrohet më tutje në fusha të ndryshme të përafrimit të legjislacionit dhe politikave të bashkëpunimit të parapara me MSA.